

59/17.

04 07 2019.

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**  
**Për Programin e studimit Bachelor “Teknikë e Lartë në Laboratorë**  
**Mjekësorë”**  
**KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”**

Grupi i vlerësimit të jashtëm:

**Dr. Nevila Heta**

**Dr. Irena Korita**



(Qershor/2019)

Faqe 1



**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASh Nr. 1, datë 06.01.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh Nr. 282, datë 04.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Teknikë e lartë në laboratorë mjekësorë
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3vite akademike/6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Nr i studenteve 2016-2017 2017-2018 2018-2019	40 studentë 9 studentë 24 studentë



## HYRJE

### Të dhëna Për Programin e studimit në Bachelor “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”

Kolegji universitar “Logos” (KU Logos) është institucion i arsimit të lartë i krijuar në vitin 2009 (liçensuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1055 dt. 29.07.2009). Ky institucion i arsimit të lartë është ngritur mbi eksperiencën 10 vjeçare të Institutit të Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, shkollë jo publike 2 vjeçare, një ndër të parat shkolla profesionale për pregatitjen e Laborantëve Mjekësorë. Në vitin 2017, SHPL Logos ka marrë statusin Kolegji Universitar (KU) Logos (Urdhër i Ministres së Arsimit dhe Shkencës Nr. 93, dt. 06.03.2017)

Kolegji Universitar “Logos” është i organizuar në dy Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike, me tre njësi bazë, përkatësisht tre departamente, Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizmi.
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, me tre njësi bazë, përkatësisht dy departamente dhe një Qëndër e Kërkimit Shkencor (Departamenti Teknikë i Lartë në Laboratorë Mjekësorë; Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor). Ky fakultet ofron programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” me kohë të plotë në:
  - Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
  - Informatikë e Zbatuar

Fakulteti ofron dhe programin e ciklit të dytë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.

- I. Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës me urdhër nr 1 datë 06/01/2010 ka miratuar hapjen e programit të ciklit të parë Bachelor “Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë”.
- II. Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës me urdhër nr 481 datë 03/10/2011 ka miratuar lejimin e ushtrimit të vëprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programit “Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë”.
- III. Sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 282 datë 4.07.2012 bazuar në vendimin Nr.338 datë 8.06.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë SHPL Logos është akredituar institucionalisht.
- IV. Sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 282 datë 4.07.2012 bazuar në vendimin Nr.338 datë 8.06.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë SHPL Logos ka akredituar për një periudhë 6 vjeçare, programet e ciklit të parë në përfundim të të cilave lëshohet diploma “Bachelor” në:
  - Menaxhim Turizmi
  - Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë
  - Menaxhim Bisnesi
  - Informatikë e Zbatuar
  - Financë Kontabilitet
  - I. Pas pezullimit të përkohshëm me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 540 datë 6.08.2014, SHPL Logos iu nënshtrua ristrukturimit duke respektuar rekomandimet përkatëse. KU Logos ka marrë akreditim institucional POZITIV me rekomandime të vlefshëm për 3 vite akademike, me vendim nr. 95 dt. 20.10.2017 të bordit të akreditimit të ASCAL.





II. Me urdhër të Ministrisë së Arsimit nr 479 datë 16/12/2015 emërtimi i programit Bachelor “Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë” u ndryshua në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”

KU Logos pas plotësimit të dokumentacionit me qëllim riakreditimin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” mbështetur në kuadrin ligjor, ka paraqitur pranë ASCAL raportin e vlerësimit të brendshëm dhe dokumentacionin shoqërues për riakreditimin e këtij programi.

#### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Dr. Nevila Heta dhe Dr. Irena Korita eksperte të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Me datë 20.06.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 25.06.2019 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

#### **Memo**

***Për Komentin që i përket konkluzionit të vlerësimit në faqen 26-27 pika 4, të RVJ,*** GVJ shqyrtoi me vëmendje shpjegimin e institucionit dhe saktëson se gjetjet e GVJ si dhe konkluzioni/rekomandimi përkatës, i cili është reflektuar në standartin 6. “Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë”, të këtij raporti lidhet me përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, gjetjet e GVJ (mungesa e procedurave, pyetësorëve të rinj të miratuar, formulari i vlerësimit të performancës së stafit (nga kolegët dhe përgjegjësi i departamentit) apo analiza/raporte përkatëse për të identifikuar problematika konkrete dhe më pas masat përkatëse për përmirësimin e tyre, nuk na u vunë në dispozicion nga institucioni përgjatë vizitës në vend.

***Gjetjet e GVJ janë bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, nga vizita në institucion dhe në gjykimin tonë, çojmë se rekomandimi i shërben pozitivisht përmirësimin të punës në institucion, dhe specifikisht aspektit të sigurimit të cilësisë në nivel programesh dhe institucional.***

***Për Komentin që i përket konkluzionit të vlerësimit në faqen 33, të RVJ,*** GVJ merr në konsideratë shpjegimin e institucionit dhe ka reflektuar në RVJ ndryshimet përkatëse duke bërë një vlerësim të përditësuar të syllabuseve. GVJ i qëndron konstatimit që në një pjesë të syllabuseve ka probleme formatimi, mospërputhje orësh dhe emertii lëndësh me programin mësimor dhe gjithashtu sugjerimit në lidhje me rishikimin e literaturës dhe vendosjes së numrit të faqeve në cdo syllabus. GVJ vlerëson se rekomandimet ndihmojnë në rritjen e cilësisë programit mësimor.



## **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË**

### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

- a) Vënia sa shpejt në funksionim e bibliotekës për studentët
- b) Të rritët numri i studentëve me tema në mbrojtje diplome
- c) Të punohët me shumë me kontrata bashkëpunimi me Institucione Publike të Arsimit të Lartë
- d) Regjistri themelor të mbyllet me vijë të kuqe dhe numër rendor
- e) Rritja e personelit akademik të brëndshëm sipas kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë

### **II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

- a) Për rekomandimin: **Vënia më sa shpejt në funksionim e bibliotekës për studentët**, institucioni ka vënë në funksionim bibliotekën e shkollës e cila është e pajisur më një sallë studimi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi praninë e literaturës në formë të teksteve mësimore dhe botimeve shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Gjithashtu GVJ evidentoi faktin që biblioteka e KU Logos është regjistruar si pjesë e bibliotekës online QUESTIA. Institucioni ka përpiluar rregullore të funksionimit të bibliotekës dhe një strategji afatshkurtër për përmirësimi e metejshëm të kushteve dhe funksionimit (perkatësisht Aneks 2.3 dhe 2.4), pjesë e të cilës është dhe procesi i dixhitalizimit.

**Rekomandimi konsiderohet i plotësuar**

- b) Për rekomandimin : **Të rritët numri i studentevë me tema në mbrojtje diplome**, institucioni ka përpunuar një rregullore në të cilën ka përcartuar kriteret për studentet të cilët mund të mbyllin ciklin e studimeve me mbrojtje diplome, numri i temave të diplomës është rritur nga 4 studentë në vitin 2015-2016, në 12 studente në vitin 2017-2018, megjithëse shifrat tregojnë rritje me 3 herë të numrit absolut , gjykimi bëhet vetëm mbi të dhënat në përqindje të numrit total të studentëve të diplomuar, këto të dhëna GJV nuk i kishte në dispozicion.

**Rekomandimi konsiderohet i plotësuar**

- f) Për rekomandimin : **Të punohet me shumë me kontrata bashkëpunimi me Institucione Publike të Arsimit të Lartë**, institucioni ka rritur numrin e marrëveshjeve me intucione homologe të arsimit të lartë si ne Shqipëri dhe jashtë. Me institucionet publike të arsimit të lartë ka marrëveshje me Universitetin Bujqësor dhe Shërbimin e Labororit Mikrobiologjik, QSUT. Një pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit janë jashtë afateve apo nuk kanë afate të përcaktuara qartë.

**Rekomandimi konsiderohet kryesisht i plotësuar**

- g) Për rekomandimin: **Regjistri themelor të mbyllet me vijë të kuqe dhe numër rendor**, institucioni vuri në dispozicion te GVJ regjistrat e plotësuar në formë manuale, me numër rendor dhe numër matkulimi, të dhënat personale dhe notat në cdo lëndë. GVJ verifikoi që regjistri mbyllet me vijë te kuqe në bazë të rekomandimit.

**Rekomandimi konsiderohet i plotësuar**

- h) Për rekomandimin: **Rritja e personelit akademik të brëndshëm sipas kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë**, institucioni ka rritur numrin e stafit akademik të brendshëm më qëllim



plotësimin e kërkesave të ligjit të arsimit të lartë, nga një personel akademik efektiv ne vitin e parë pas akreditimit 2013-2014, personeli akademik efektiv në vitin akademik 2018-2019 është pesë, **megjithatë institucioni nuk plotëson ende kërkesat e ligjit.**  
**Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i plotësuar**

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end.



# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Misioni i programit të studimit të ciklit parë Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është t'u japë studentëve përgatitje profesionale si teorike ashtu dhe praktike në lidhje me teknikat bazë të cilat aplikohen në laboratorët mjekësorë, përkatësisht në fushat e Kimisë Klinike, Hematologji, Mikrobiologji dhe Histopatologji. Njohuritë të cilat ofrohen në këtë program i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e laboratorëve mjekësorë duke i bërë konkurentë në tregun e punës në sektorët publikë e privatë. Gjithashtu u mundëson atyre ndjekjen e studimeve më të avancuara në ciklin e dytë të studimeve ( master profesional dhe master shkencor)

Objektivat në përgjithësi janë të qarta profesionalisht, të justifikueshme dhe të arritshme. Planet dhe programet mësimore në përgjithësi janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe kërkesat e sistemit të Bolonjës.

Stafi akademik në përgjithësi ka kualifikimin e nevojshëm për të realizuar programin mësimor në këtë cikël studimi. Ambientet për organizimin e procesit mësimor janë të përshtatëshme. Në funksion të programit janë tre laboratorë specifikë: mikrobiologjik, biokimik – klinik, histopatologjik, të cilët në strategjinë e institucionit parashikohet të plotësohen me aparatura të teknologjisë më të avancuar. Bashkëpunimi me qendra mjekësore diagnostike publike dhe private krijon mundësi aftësimi praktik për studentët. Biblioteka ka një numër titujsh që i vijnë në ndihmë studentit për plotësimin e njohurive bazë të programit si dhe për zgjerimin e njohurive në fusha specifike gjatë punimit të temave të diplomës.

Pjesë e plotësimit të objektivave të programit “Bachelor” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është hartimi dhe zbatimi i një strategjie afatshkurtër afatmesëm dhe afatgjatë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit si rivlerësimi i vazhdueshëm i syllabuseve në përputhje me zhvillimin e kërkesave aktuale të diagnostikës laboratorike, përmirësimi i teknologjisë i laboreve eksistues, rritja e cilesisë së mësimdhënies, rritja e bashkëpunimit me instucione homologe dhe shëndetsore.

Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” i referohet nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe organizohet në 180 kredite europiane (ECTS). Programi është hapur për herë të parë në bazë urdhërit Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës më datë 03/10/2011 dhe gjatë ketyre viteve ka pësuar ndryshime të rëndësishme si në shtimin e lëndëve, shpërndarjen e krediteve, rishpërndarjen e lëndëve në vitet akademike, rishikimin dhe riorganizimin e syllabuseve. Studentët diplomohet me provim përfundimtar ose me diplomë në bazë të kriterëve të përcaktuara nga institucioni.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	



<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”, përmban elementët e domosdoshëm për të përmbushur misionin e Institucionit duke i dhënë studentëve njohuri bazë dhe kompetencë në funksion të realizimit të objektivave për formimin teorik – praktik të specialistëve “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. Këto objektiva janë të përcaktuara qartë si në planin teorik ashtu edhe praktik duke i dhënë studentit kompetencën e duhur profesionale në përputhje me profilin e studimit dhe duke mundësuar që pas përfundimit të këtij cikli studimi të këtë aftësitë e duhura tregun e punës. Në Shqipëri nuk kemi studime të plota për nevojat e tregut të punës për specialistë, profesionistë në Laboratorin Mjekësor. Megjithatë janë disa fakte të rëndësishme që justifikojnë krejtësisht ekzistencën e një programi të tillë studimi: numri i madh i laboratorëve private dhe shtetërore eksistues, zhvillimi i vrullshëm i shkencave mjeksore ku metodat diagnostike laboratorike po përmirësohen dhe shtohen, po kërkohet zhvillimi dhe zbulimi i markuesve të rinj laboratorik në ndihmë të diagnozës së pacientit, numri dhe llojshmëria e ekzaminimeve të kërkuara në Shqipëri po rritet shumë. Zhvillimi social dhe ekonomik i vendit në përgjithësi, kërkon burime njerëzore të kualifikuara me një bazë të gjerë dhe të përshtatshme dijesh. Mendojmë se ky program studimi është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe integritit.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Institucioni deklaron në mënyrë të përmbledhur në planin strategjik të Departamentit “Teknikë të Lartë në Laborator Mjekësor” strategjitë e zhvillimit afatshkurtër (2017 – 2019), afatmesëm (2019 – 2021) dhe afatgjatë (2021 – 2024). Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacioneve të vëna në dispozicion vlerësojmë si arritje të strategjisë afatshkurtër:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rishikimin e syllabuseve të lëndëve dhe planeve mësimore</li> <li>- lidhjen e kontratave të bashkëpunimit me institucione ku studentët realizojnë praktikën dhe përgatisin tezën e diplomës.</li> <li>- Shtimin e bashkëpunimeve ndër-institucionale për zhvillimin e aktiviteteve shkencore.</li> </ul> <p>Është ecur më ngadalë në përmbushjen e synimit strategjik për ngritjen e strukturave didaktiko mësimore, të strukturave laboratorike me kapacitete më të mëdha diagnostikuese në përputhje me programin e studimit.</p>



	<p>Strategjia afatmesme dhe afatgjatë e SHLP Logos konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rishikimin e programit me synim përmirësimin, përditësimin me kërkesat e kohës sidomos për lëndët Histopatologji, Immunologji Klinike dhe Biologji Molekulare.</li> <li>- plotësimin në rritje të kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në këto lëndë, me teknologji bashkëkohore (ngritje e laboratoreve).</li> <li>- Shtimin e numrit të studentëve që zhvillojnë temat e diplomave në këto fusha.</li> </ul> <p>Programet e ofruara të studimit mund të konsiderohen të përshtatura mirë me këtë strategji të zhvillimit të institucionit. Keto programe i ofrojnë studentit informacionet e nevojshme të shkencave bazë mbi të cilat ngrihen parimet e përgjithshme të Mjekësisë Laboratorike dhe me tej informacione bazë në lidhje me specialitete te vecanta si Kimia Klinike, Hematologjia, Immunologjia, Histopatologjia etj. Programi i lejon studenteve që në fushat e vecanta të sipërpërmendura të fitojnë kompetencën e shprehitë e duhura duke i dhënë mundësinë e aplikimit të njohurive në të gjitha nënspecialitetet e mjekësisë laboratorike.</p>
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>  <b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”, ka synim të plotësojë kërkesat gjithnjë e në rritje të tregut të punës për specialistë shëndetësorë në përgjithësi dhe teknikë të laboratorëve mjekësorë në vecanti. Zhvillimi social dhe ekonomik i vendit këkon rritje në shtrirje dhe cilesi të shërbimit shëndetësor të popullsisë duke kërkuar shtim të burimeve njerëzore sa më të kualifikuara. Mendojmë se ky program studimi është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik.</p> <p>Institucioni disponon dokumentacionit përkates në lidhje me punësimin e të diplomuarve dhe studimin e tregut, numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme. Institucioni synon të bëhet pjesë e projektit GRADUA, një platformë kjo që pretendohet të prodhojë të dhëna në lidhje mundësitë që ofrohen nga tregu i punës, kërkesat e punëdhënësve etj. Studimi i tregut momentalisht është bazuar në evidentimin e pranisë së një numri të lartë të laboratorëve në Shqipëri, prioriteti që ka shërbimi shëndetsor në politikat qeveritare, zhvillimit të vullshëm të teknologjisë. Instucioni nuk arrin të bëjë një parashikim</p>



	përafërt të studentëve të ardhshëm.
<b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;	Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, ofrimi i programeve në fushën e shëndetësisë lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien e vëndit, kjo është një vlerë për instucionit. Promovimi i vlerave kombëtarë realizohet gjithashtu edhe ndërmjet aktiviteteve social-kulturore të organizuara.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është hartuar në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e Institucionit dhe mbështet strategjinë për zhvillim të tij.</li> <li>2. Institucioni për përmbushjen e misionit të tij është organizuar në përputhje të plotë me infrastrukturën ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke ruajtur autonominë dhe lirinë akademike për aq sa e lejon ligji.</li> <li>3. Programi është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucionit si dhe parashikon modifikime e përmirësime në përputhje me rezultatet e arritura dhe me kërkesat e zhvillimit të profesionit dhe sistemit laboratorik në Shqipëri.</li> <li>4. Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është i organizuar me kohë të plotë, me kohëzgjatje tre vite akademik, dhe me 180 kredite.</li> <li>5. Ky program studimi ka marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës. Institucioni synon të bëhet pjesë e projektit GRADUA me qëllim marrjen e të dhënave më të sakta në lidhje më tregun e punës dhe numrin e të diplomuarvë në programe të ngjashme.</li> <li>6. Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, ofrimi i programeve në fushën e shëndëtsisë është lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien e vëndit, kjo është një vlerë për instucionit.</li> </ol>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i cili ofron edhe programin e studimit objekt i këtij raporti, përbëhet nga tre njësi bazë, përkatësisht dy departamente dhe një Qëndër e Kërkimit Shkencor (Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë; Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor). Ky fakultet ofron programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” me kohë të plotë në:

- Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
- Informatikë e Zbatuar



Grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me organizimin hierarkik, organiogramën e fakultetit, stafet në përbërje të njësisve etj.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura akademike e Fakultetit

Programi i studimit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara. Në dokumentacionin e vënë në dispozicionin tonë verifikohet organizimi hierarkik. Në krye të piramidës drejtuese është Senati i Universitetit dhe Rektori; në varësi të tyre është Dekani dhe Asambleja e Personelit Akademik. Fakulteti përbëhet nga dy departamente: Departamenti “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” dhe Departamenti “Informatikë e Zbatuar”. Fakulteti ka dhe një Qëndër Kërkimi. KU Logos ka ngritur dhe Bordin e Administrimit në varësinë e të cilit është dhe Administratori i Njesisë Kryesore.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është departamenti përgjegjës për programin Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë, ky departament përbëhet nga 5(pesë) anëtarë personel akademik efektiv, nga të cilët 1(një) me titullin profesor në Mjekësi, 2(dy) me gradën shkencore doktor në Shkencat e Sakta, dhe 2 (dy) në proces doktorature. Personeli akademik me kontratë përbëhet nga 2 ( dy) me gradën shkencore doktor në Mjekësi dhe 1(një) master shkencor. Të tre anëtarët e personelit akademik me kontratë janë mjekë specialiste përkatësisht në specialitetet: 1(një) Laborator Mikrobiologjik, 2(dy) Laborator Biokimik-Klinik. Personeli ndihmës akademik në këtë program është 2(dy). **Numri i stafit akademik ka ndryshuar në menyrë dinamike** gjatë viteve pas akreditimit të parë si më poshtë:

Viti akademik 2012-2013, 2(dy) PAE dhe 20(njëzet) PAK; viti akademik 2013-2014, 1(një) PAE dhe 15(pesëmbëdhjetë) PAK ; viti akademik 2014-2015, 6(gjashte) PAE dhe 6(gjashte) PAK ; viti akademik 2015-2016, 6(gjashte) PAE dhe 6(gjashte) PAK ; viti akademik 2016-2017, 7(shtatë) PAE dhe 10(dhjetë) PAK; viti akademik 2017-2018 6(gjashte) PAE dhe 5(pesë) PAK. Ndryshimi më i rëndësishëm ka ndodhur në vitin akademik 2014-2015 ku janë rekrutuar rishtas 6( gjashtë) pedagogë efektivë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Pas vlerësimit të dosjes së bashku me dokumentat e aplikimit dhe vizitës së realizuar në institucion, GVJ arriti të kishte të dhënat e nevojshme lidhur me personelin akademik efektiv, personelin akademik me kontratë dhe personelin administrativ. Të dhënat e përshkuara në RVJ përfshinin 6 vite akademike, duke filluar nga viti akademik 2012-2013 deri në vitin akademik 2017-2018, pa përfshirë vitin akademik aktual akademik 2018-2019. GVJ mori informacione të hollësishme dhe gjithashtu dokumentacion shtesë me tabela të përditësuara për vitin akademik 2018-2019.

Gjatë vlerësimit të RVJ dhe dokumentacionit GVJ evidentoi që Departamenti “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ka 5 anëtarë efektivë nga 6 të deklaruar në RVJ si personel akademik efektiv.

**Theksojmë se panvarësisht ndryshimit të numrit të PE instucioni, nuk përmbushte dhe nuk përmbush kërkesat e ligjit 80/2015, neni 25, pika 4, për numrin minimal të anëtarëve.** Gjatë vizitës në instucion na u vu në dispocion urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr 29 date 21.01.2019 : Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e numrit të stafit akademik me kohë të plotë për secilën njësi bazë në kolegjin universitar “Logos”.



### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Pas njohjes me dosjen e aplikimit dhe vizitës së kryer në ambientet e KU "Logos", grupi i vlerësimit të jashtëm arriti të kishte të dhënat e nevojshme lidhur me personelin akademik, personelin administrativ, shpërndarjen e ngarkesave mësimore mes personelit efektiv dhe personelit me kontratë për programin e "Bachelor" në Teknik i Lartë i Laboratorit Mjekësor. Të dhënat në RVB i përkisnin vitit akademik 2017-2018 dhe jo atij aktual, gjithashtu kishte pasaktësi në menyrën e përlllogaritjes së raporteve. Gjatë vizitës në institucion na u vunë në dispozicion dokumenta shtesë dhe gjithashtu të dhëna të përditësuara edhe për vitin akademik 2018-2019.

Raporti PAE/PAK është 77%: 23%, raporti PAE/PA është 83%: 17% dhe raporti PAE /student 112/10, afërsisht 11 studentë mbulohen nga një pedagog.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimit e Lartë dhe Kërkimin Shkencor Neni 59 pika 8 ku përcaktohet që institucionet Jopublike të Arsimit të Lartë përcaktojnë vetë ngarkesën mesimore. Gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion raporti i Departamentit Përgjegjës në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-2019. **Nuk vihet re mbingarkesë në orët mësimore të stafit akademik si efektiv ashtu dhe atij me kontratë, përveç rasteve të pedagoqeve efektive të cilët kryejnë dhe funksione administrative, ngarkesa mesimore e të cilëve duhet të jetë më e reduktuar.**

Ne u njohëm gjithashtu me mënyrat e rekrutimit të personelit dhe tipin e kontratës për të dy kategoritë e punonjësve akademike (PAE dhe PAK). Institucioni disponon rregullore të vecantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat në Aneks)

Në programin e studimit "Bachelor" në **Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor** është angazhuar drejtpërdrejt Departamenti "**Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor**" i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara me 5(pesë) anëtarë personel akademik efektiv, Qendra e Kërkimit Shkencor me 5(pesë) anëtarë personel akademik efektiv. Për realizimin e programit janë angazhuar dhe 3 (tre) anëtarë personel akademik me kontratë si dhe personeli ndihmës akademik 2 (dy).

Stafi akademik gjate 6 viteve te fundit ka pasur dinamike të rëndësishme ndryshimi, konkretisht në vitin akademik 2012-2013 raporti PAE/ PAK ka qënë 2/20, vitin akademik 2013-2014 raporti PAE/ PAK ka





qënë 1/15, vitin akademik 2014-2015 raporti PAE/ PAK ka qënë 6/6, vitin akademik 2015-2016 raporti PAE/ PAK ka qënë 6/6, vitin akademik 2016-2017 raporti PAE/ PAK ka qënë 7/10, vitin akademik 2017-2018 raporti PAE/ PAK ka qënë 6/5.

**Nuk vihet re mbingarkesë në orët mësimore të stafit akademik si efektiv ashtu dhe atij me kontratë, përveç rasteve të pedagogëve efektive të cilët kryejnë dhe funksione administrative, ngarkesa mesimore e të cilëve duhet të jetë më e reduktuar.**

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat në Aneks)

Shpërndarja e titujve dhe gradave të stafit akademik të angazhaur në këtë program studimi konkretisht është: 3(tre) titull akademik profesor, 1(një) profesor i asociuar, 3(tre) me gradën doktor, 2(dy) në proces doktoraturë dhe 1(një) master shkencor. Numri i stafit akademik ndihmës është 2(dy). Personeli akademik me kontratë është : 2 ( dy) me gradën shkencore doktor dhe 1(një) master shkencor. Të tre anëtarët e personelit akademik me kontratë janë mjekë specialiste përkatësisht në specialitetet: 1(një) Laborator Mikrobiologjik, 2(dy) Laborator Biokimik-Klinik. Personeli akademik që mbulon programin “Bachelor” **përbëhet kryesisht** nga pedagogë me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse.

Personeli i rekrutuar gjate 6 viteve te fundit ka pasur dinamike të rëndësishme ndryshimi në terma të kualifikimit. Për stafin PAe konkretisht: në vitin akademik 2012-2013, 1 (një) ) titull akademik profesor, 1(një) master shkencor ; për vitin akademik 2013-2014 , 1 (një) ) titull akademik profesor ; vitin akademik 2014-2015, 1 (një) ) titull akademik profesor , 4(katër) në proces doktoraturë dhe 1(një) master shkencor; vitin akademik 2015-2016 , 1 (një) ) titull akademik profesor , 4(katër) në proces doktoraturë dhe 2(dy) master shkencor; vitin akademik 2016-2017, 2 (dy)) titull akademik profesor, 1(një) profesor i asociuar, 4(katër) me gradën doktor, 2(dy) në proces doktoraturë dhe 2(dy) master shkencor; vitin akademik 2017-2018, 3(tre) titull akademik profesor, 1(një) profesor i asociuar, 4(katër) me gradën doktor, 2(dy) në proces doktoraturë dhe 1(një) master shkencor.

Të dhënat sipas seksit (Tabelat në Aneks)

Në personelin akademik efektiv të departamentit “**Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor**” raporti meshkuj/femra është **5/5**. Ndërsa në PAE të angazhuar në programin e studimit raporti është **3/0**. Vihet rë një numër i lartë i femrave të përfshira në proceset akademike në përgjithësi, vecanërisht në degët e Mjekësisë Laboratorike.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Mosha e personelit akademik efektiv, **vihet re të jetë e lartë në këtë program studimi** , 5(pesë) nga 10(dhjetë) pedagogë janë të moshës mbi 66 vjec, ndërsa në personelin me kontratë tentohet drejt një moshe më të re, grup mosha predominante në këtë kategori është 35-45 vjec.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Grupi i punës u njoh me modelet e kontratave të punës, me procedurat e rekrutimit të stafit etj. Në diskutim me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Gjatë vizitës në institucion GVJ verifikoi kontratat e punës për të gjithë stafit akademik efektiv dhe me kontratë.



- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe ndihmës mësimor dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion konsultuam dhe disa dokumentacione të tjera si dosje të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, dokumentacione të rekrutimit të pedagogëve të rinj, skemen e procedurës së rekrutimit të pedagogëve, dokumente të shpërndarjes së ngarkesës mësimore të stafit akademik etj.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Procedurat e rekrutimit të personelit janë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e sanksionuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Stafit akademik i punësuar me kohë të <b>plotë përbën 77% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit bachelor në Teknik i Lartë i Laboratorit Mjekësor, i cili mbulon 78% të krediteve të programit të studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor. Numri i lëndëve që mbulon stafi akademik PAE është konkretisht: 2 PAE mbulojnë 2 lënde , 5 PAE mbulojnë 3 lënde dhe 3 PAE mbulojnë 4 lëndë. Ngarkesa maksimale e stafit PAE është 270 orë mësimore. GVJ vë re mbingarkesë në orë mësimore në stafin akademik efektiv i cili kryen funksione administrative.</b></p> <p>Stafi akademik gjate 6 viteve te fundit ka pasur dinamike të rëndësishme ndryshimi, konkretisht në vitin akademik 2012-2013 raporti PAE/ PAK ka qënë 10%, vitin akademik 2013-2014 raporti PAE/ PAK ka qënë 6.6%, vitin akademik 2014-2015 raporti PAE/ PAK ka qënë 50%, vitin akademik 2015-2016 raporti PAE/ PAK ka qënë 50%, vitin akademik 2016-2017 raporti PAE/ PAK ka qënë 70%, vitin akademik 2017-2018 raporti PAE/ PAK ka qënë 75%.</p> <p>Në statutin dhe rregulloren e institucionit janë përcaktuar procedurat ligjore për vlerësimin e personelit. Këto procedura janë transparente dhe përfshijnë: realizimin e ngarkesës mësimore të normuar, punën kërkimore-</p>



	<p>shkencore, kualifikimin, pjesmarrjen në konferenca dhe referimin në to, planin e botimeve etj.</p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash mbi raportet e rekrutimit të personelit (dosje individuale), njoftimeve për vende të lira pune etj.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik. (dokumentacioni u verifikua).</p> <p>Institucioni (koordinatori i programit) disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrative</p> <p>Institucioni përcakton dhe publikon në median e shkruar dhe elektronike, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët.</p> <p><i>Në lëndët e gjuhëve të huaja titullarët e lëndëve nuk kanë titullin profesor i asociuar. GVJ i këshilloi intutucionit zbatimit e standartateve të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë.</i></p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; kjo u konstatua qartë nga grupi i vlerësimit gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor. Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ dëshmoi të ishte i angazhar në përmbushjen e objektivave të programit. Programi Bachelor në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë nuk përfshin praktika profesionale. Praktikrat profesionale jashtë instucionit nuk janë të detyrueshme në këtë program, megjithatë gjatë vizitës u informuam që një pjesë e mirë e studentëve kryenin praktika profesionale në institucione që mund ti sigurojnë vet.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b></p>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni dëshmon me anë të dokumentacionit të verifikuar, organizimin e disa aktiviteteve shkencore dhe leksioneve të hapura në funksion të kualifikimit profesional të personelit akademik, në gjykimin tonë këto aktivitete duhet të jenë më të shpeshta ku të jënë të ftuar personalitete të spikutura shkencore si vendas dhe të huaja. Të dhënat që lidhen me programin e studimit Bachelor në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë janë të pranishme pranë Departamentit përgjegjes.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Procedurat e rekrutimit të personelit janë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e sanksionuara në statutin dhe rregulloren e institucionit.</li> <li>2. Personeli akademik ndihmës dhe administrativ është i angazhuar dhe punon me përkushtim për përmbushjen e objektivave të programit të studimit “Bachelor” në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë. Ai plotëson përgjithësisht detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucioni disponon një bazë të dhënash përfshirë dosjet individuale të tyre (CV, Informacioni mbi diplomat, kërkimin shkencor etj.) si dhe për shpërndarjen e ngarkesës mësimore vjetore.</li> <li>3. Staf i akademik i punësuar me kohë të <b>plotë përbën 77% të personelit</b> akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit bachelor në Teknikë i Lartë i Laboratorit Mjekësor, i <b>cili mbulon 78% të krediteve të programit</b> të studimit Bachelor në <b>Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor</b></li> <li>4. Moshë e personelit akademik efektiv, <b>vihet re të jetë e lartë në këtë program studimi</b></li> <li>5. Drejtimi i lëndëve e moduleve realizohet nga titullarë të cilët kanë titullin profesor i asociuar përvëc lëndëve të gjuhëve të huaja, <b>GVI i këshilloi institucionit zbatimin e standartave të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë.</b></li> <li>6. Në shpërndarjen e ngarkesës mësimore vihet re <b>mbingarkesë në orë mësimore në stafin akademik efektiv i cili kryen funksione administrati.</b></li> </ol>	

**4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Në kolegjin universitar “Logos”, gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit të jashtëm, u verifikuan mjediset ku zhvillohej programi i studimit. Veprimtaria mësimore zhvillohej në një godinë me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 4590 m<sup>2</sup>, ndërtuar me materiale cilësore. Në sallat mësimore sigurohet akustikë e mirë, ndriçim i mirë, si dhe sistem ngrohje qendrore me kaldajë dhe me kondicioner për të gjithë godinën. Grupi i vlerësimit konstatoi të plotësueshme kushtet higjieno-sanitare në godinën e KU “Logos”.

Në dokumentacionin shoqërues të RVB (Aneksi 4.1) është paraqitur tabela përmbledhëse e ndarjes dhe organizimit të ambienteve mësimore dhe ndihmëse të KU Logos, të cilat u verifikuan gjatë vizitës në



institucion. Dokumentet shoqëruese janë planimetritë e detajuara të ambienteve, kontrata e huapërdorjes së ambienteve, akt – miratimi higjienosanitar dhe çertifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Në tabelën 7 të RVB janë përmbledhur të detajuara mjediset për Fakultetin përgjegjës për programin e studimit, si më poshtë:

Në godinë përfshihen 4 salla leksionesh, 2 salla seminaresh, 1 sallë konferencash, 3 laboratorë, përkatësisht laborator biokimik - klinik, mikrobiologjik, histopatologjik, 3 laboratorë informatike të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme, bibliotekë. Gjithashtu në dispozicion të stafit akademik dhe administrativ, si njësi përbërëse të rektoratit janë 11 zyra. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me pajisjet e nevojshme (videoprojektor, kompjuter të lidhur me internet, sistem ngrohje dhe ftohje me kondicionim-ventilim me inverter etj.), në funksion të zhvillimit të procesit mësimor duke iu ofruar komoditetet e nevojshme studentëve dhe stafit akademik. Zyrat për personelin akademik dhe administrativ janë të mjaftueshme e komode për punë individuale, të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme logjistike.

Nga vizita në vend ne konstatuam që fondi i teksteve dhe literaturës që i referohet programi Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë ka pësuar rritje gjatë viteve të fundit. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse në funksion të programit të studimit u ofrohet studentëve në formën e teksteve mësimore bazë në bibliotekën e KU "Logos". Ato gjenden në formë hard copy (3-5 kopje për çdo titull) apo në formë elektronike në bibliotekat online, ku studentët e kolegjit mund ti aksesojnë pa pagesë.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Mjediset për Programin e studimit (Tabelat në Aneks)

Nga inspektimi në vend ne pamë se në funksion të zhvillimit normal të këtij programi kishte mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura mirë me infrastrukturën e duhur. Kolegji kishte salla leksioni/seminari, sallë konference, laborator informatike, sallë biblioteke, si dhe mjedise të tjera shërbimi. Të gjitha këto ambiente ishin me sipërfaqe të bollshme dhe të pajisura mirë.

- Salla për leksione: 4
- Klasa për seminare: 2
- Salla për aktivitete promovuese: 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët: 3
- Laboratorë informatike: 3
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë: 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj: 1
- Zyrë informacioni për studentët: 1
- Nyje hidrosanitare: 4



Mjediset për stafin:

GVJ, gjatë vizitës në institucion verifikuam mjediset për stafin. Këto mjedise përfshinin zyrat për drejtuesit, pedagogët, njësitë e shërbimit, etj. Këto ambiente ishin me sipërfaqe të bollshme dhe të pajisura me infrastrukturën përkatëse.

Të dhëna të detajuara për mjediset për programin dhe stafin, jepen në tabelat më poshtë:

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	4	243
Klasa për seminare	2	79
Salla për aktivitete promovuese	1	120
Salla për praktikë lëndore/ profesionale		
Laboratorë për lëndët	3	170
Laboratorë informatike	3	150
Salla interneti		
Salla për bibliotekë	1	100
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	5
Zyrë informacioni për studentët	1	8
Korridore/holle		190
Mjedise sportive	1	250
Mjedise shërbimi për të tretë		
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore		
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj		
Nyje hidrosanitare për studentët	4	60
Etj....		
<b>Norma m<sup>2</sup>/për student</b>		<b>12m<sup>2</sup>/student</b>

Mjediset për stafin:

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	2	50
Zyra për sekretarinë mësimore	1	12
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	3	30
Zyra për personelin akademik	3	70
Zyrë për financën	1	9
Zyrë për Njësinë e SBC	1	15
Salla për mbledhje	1	60
Mjedis për stafin e shërbimit	1	6
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	8	120



Norma m<sup>2</sup>/për person

18 m<sup>2</sup>/për person

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin: 2
- Zyra për sekretarinë mësimore: 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore: 3
- Zyra për personelin akademik: 3

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion verifikuam të gjitha mjediset ku zhvillohej programi mësimor i programit të studimit të TLLM, si dhe mjediset e bibliotekës, dhe konstatojmë që të dhënat e dosjes së vetëvlerësimit përputhen me gjendjen e konstatuar.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	KU Logos ka vënë në dispozicion të programit Bsc Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” tekstet bazë dhe literaturë ndihmëse, e cila gjendet në mjediset e bibliotekës së Kolegjit.
<b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Kjo literaturë është bashkëkohore dhe pasqyrohet relativisht mirë në syllabuset përkatëse të secilës lëndë mësimore. Tekstet bazë janë kryesisht tekste të autorëve vendas, si dhe disa tekste ndërkombëtare për studentët.
<b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	Biblioteka së fundmi ishte pasuruar me një fond të tërë tekstesh dhe në fushën e teknikave laboratorike. Librat që ndodhen në bibliotekë janë të inventarizuar. Fondi i Bibliotekës është ngritur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe stafit akademik e administrativ.
<b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;	Në bibliotekë gjenden botime periodike dhe librari elektronike e cila është siguruar nga bashkëpunimi me Universitetin e Pireut ( <a href="http://digilib.lib.unipi.gr/ket/">http://digilib.lib.unipi.gr/ket/</a> )
<b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.	Fondi i pasur i botimeve periodike dhe bibliotekës elektronike i ofron studentëve të programit të studimit Bachelor “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” të gjitha mundësitë për përmbushjen me sukses të kërkesave të programit të studimit si dhe për kryerjen e hulumtimeve të ndryshme në lidhje me përgatitjen e



	<p>detyrave, projekteve, temave të diplomimit etj.</p> <p>Oraret e punës të bibliotekës janë të shpallura në faqen online zyrtare të Kolegjit. Biblioteka funksionon me orar shërbimi në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve dhe stafit.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e godinës të kolegjit rezulton se Institucioni disponon në sasi të mjaftueshme laboratorë, klasa, zyra, laboratorë informatike, sallë konferencash, salla leksioni dhe seminaresh të paisura me pajisje elektronike për prezantim.</p> <p>Mjediset mësimore janë të mobiluara në mënyrë të përshtatshme për një ambient universitar. Pajisja e sallave të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve është e përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Laboratorët (3) kanë hapësirë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e gjithë studentëve. Po ashtu personeli ndihmës mësimor-shkencor është i kualifikuar dhe i agazhuar në mirëmbajtjen e laboratoreve dhe në asistencën e studentëve e pedagogëve gjatë praktikave laboratorike</p> <p>Tre laboratorët: biokimik-klinik, mikrobiologjik, histopatologjik në funksion të programit Bsc TL, janë të paisur me aparatura, reagentë dhe pajisje laboratorike, si dhe mjete të tjera didaktike (tabela prezantuese, skedarë lamash, materiale histopatologjike etj.), të domosdoshme për zhvillimin e programit të studimit.</p> <p>Niveli i paisjeve mësimore dhe parametrat e tyre teknik ishin mjaft të mira duke i paraprirë edhe zhvillimeve të mundshme sasiore në të ardhmen të programit “Bachelor në Teknik Laboratori”.</p> <p>Institucioni, po ashtu garanton me kapacitetet që ka si dhe me bashkëpunimin e ofruar nga institucione të tjera me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi që të siguroj për të gjithë studentët e programit mësimor TLLM zhvillimin e praktikave profesionale.</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p> <p>1. Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit paraqitet e përshtatshme dhe e mjaftueshme për realizimin e tij.</p> <p>2. Ambientet janë paisur e dedikuar për leksione, seminare, laboratorë mjekësorë e të informatikës për zhvillimin normal të planit mësimor. Sallat e leksioneve/seminareve, biblioteka, zyrat e personelit dhe administratës kanë gjithë infrastrukturën e nevojshme në funksion të qëllimit të tyre. Nga ana tjetër pajisjet në</p>	



funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë bashkëkohore dhe me parametra teknik të pëlqyeshëm.

3. Tre laboratorët: biokimik-klinik, mikrobiologjik, histopatologjik në funksion të programit Bsc TL, janë të paisur me aparatura, reagentë dhe pajisje laboratorike, si dhe mjete të tjera didaktike (tabela prezantuese, skedarë lamash, materiale histopatologjike etj.), të domosdoshme për zhvillimin e programit të studimit.

4. Është e nevojshme që të garantohet mirëmbajtja e aparaturave dhe pajisjeve laboratorike, që të sigurohet funksionimi i rregullt i tyre

5. Furnizimi me reagent dhe me pajisjet laboratorike, duhet të jetë i garantuar përgjatë gjithë vitit mësimor në mënyrë që të mos kemi asnjë mungesë në zhvillimin e praktikave laboratorike.

6. Biblioteka është e paisur me literaturë universitare në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaj si dhe disponon librarinë elektronike.

7. Në ambientet kreative në funksion të shërbimit të studentit dhe pedagogëve është dhe palestra e menaxhuar nga staf profesionist dhe e paisur në mënyrë bashkëkohore.

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

KU Logos është institucion jofitimprurës që funksionon financiarisht dhe juridikisht brenda fondacionit Logos. Institucioni deklaron si burime financimi të ardhurat nga kuotat e shkollimit të studentëve, financimin nga Kryepiskopi i KOASH, Prof. Dr. Anastas, president dhe themelues i fondacionit dhe donacionet nga organizata e individë, brenda akteve ligjore në fuqi. Pasqyrat financiare (bilanc vjetor) përgatiten dhe depozitohen pranë organeve tatimore në nivel fondacioni (kjo për shkak të natyrës së veçantë të shkollës (jofitimprurës).

Nga kolegji, ndiqen politika lehtësuese financiare si: pagesa me këste e tarifës së shkollimit, bursat për studentët në nevojë apo me aftësi të veçanta.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)



- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Bazuar në tabelën nr. 8 të RVB janë plotësuar të ardhurat dhe financimet që nga viti 2012-2013 deri në vitin akademik 2017-2018.

- Grantet për kërkim 0 % . Në RVB dhe nga takimet e realizuara theksohet që aktualisht institucioni nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.
- Konsulencat, shërbimet 0 % .
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit . Në faqen 44, te RVB, thuhet vetëm që të ardhurat nga gjithë studentët për vitin 2016-2017 rezultojnë 52.500.000 lekë në total.
- Sponsorizimet 0 %.
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0 % .
- Donacionet, aktivitetet siguruese, përqindja e këtij zëri ndryshon ndër vite të ndryshme shkollore. Psh, për vitin 2017-2018, zënë 41.8 % të shumës së të ardhurave. Për vitin 2016-2017, 35.3 %, të shumës së të ardhurave. Për vitin 2015-2016, 20.9 %, të shumës së të ardhurave. Për vitin 2014-2015, 33.6 %, të shumës së të ardhurave. Për vitin 2013-2014, 40.1 %, të shumës së të ardhurave. Për vitin 2012-2013, 24.1 %, të shumës së të ardhurave.
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0 %.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Bazuar në RVB dhe ne takimet e realizuar, rezultojnë që kostoja për student në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara për vitin akademik 2016-2017 është 213,724.88, ndërsa për vitin akademik 2017-2018 kostoja për student është më e lartë 230,090.33. Vihet re që kosto e studimit për student rezultojnë të larta në këtë program studimi dhe nga viti në vit më të larta se në vitin paraardhës, psh në vitin 2017-2018 më të larta se në vitin 2016-2017. Kjo për shkak dhe të politikave të institucionit që pa ndryshuar tarifën e shkollimit ka shtuar shpenzimet për të plotësuar më së miri çdo lloj kërkese në ngritjen e cilësisë së programit të studimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion konsultuam disa dokumente për mbështetjen e aktivitetit shkencor të stafit akademik, vendime të Senatit Akademik dhe Rektoratit për akordimin e Bursave të studimit për studentë të ekselencës dhe bursa sociale.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	Për KU Logos bëhet auditim i përvitshëm i situatës financiare të tij në kuadër të fondacionit "Logos". Në raportet e auditit jepet opinioni i audituesit për pasqyrën financiare të Fondacionit, paraqiten detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;
<b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit,	Institucioni aktualisht nuk përfiton asnjë grant të huaj që



<p>shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>përfitohen nga kontratat e shërbimeve. Institucioni është jo-fitimprurës dhe mbulon shpenzimet e kërkuara për realizimin e programit të studimit nga ana e Fondacionit “Logos”</p>
<p><b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>  <b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>KU Logos ka raporte financiare vjetore për çdo vit buxhetor, të certifikuar nga ekspertë të fushës. KU dokumenton raportet financiare pranë zyrës së financës për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Ofron qëndrueshmëri financiare, sepse përveç të ardhurave nga tarifat e shkollimit të studentëve Kryepiskopi i KOASH, Prof. Dr. Anastasi, themeluesi i Fondacionit “LOGOS”, siguron qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. KU Logos është institucion financiar jofitimprurës që funksionon brenda Fondacionit Logos, që garanton financiarisht institucionin.</li> <li>2. Të ardhura të tjera deklarohen të ardhurat nga tarifat e shkollimit të studentëve, donacionet dhe fondet jopublike.</li> <li>3. Tipari jofitimprurës është specifikë e KU Logos dhe pasqyrohet në politikat që ndjek ky institucion në mbështetje të studentëve.</li> <li>4. Tipari jofitimprurës është përparësi për KU “Logos”, sepse përfitojnë bursa jo vetëm studentët me mesatare mbi 9, por përfitojnë bursa sociale dhe studentët që janë në vështirësi ekonomike.</li> </ol>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.



Kolegji Universitar "LOGOS", që në hapat e para të krijimit të tij (ish SHLP "LOGOS"-2011), ka ngritur pranë institucionit njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NjSBC) me qëllim vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë mësimore, kërkimore, financiare, administrative të institucionit në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr.9741, datë 21.05.2007.

Në mbështetje të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë nr.80/2015, Senati Akademik miratoi me vendimin nr.7 , datë 13.02.2017 formimin në nivel institucional duke e shtrirë dhe në nivel të njësive pranë Fakulteteve grupin e punës për vlerësimin e sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Në vijim, me vendimin nr.43, datë 08.02.2018 vendosi të miratoj rifreskimin në nivel institucional të grupit të punës për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë duke shtuar numrin nga 4 anëtarë në 6 anëtarë, me shtimin e një eksperti të jashtëm dhe një studenti, si dhe në grupin e njësive të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, nga 2 anëtarë në 4 anëtar, duke shtuar dy anëtar student.

Referuar dokumentacionit të bashkëlidhur RVB, rezulton se ka një "mix" vendimesh për rifreskime të NjSBC, pa kuptuar qartë rolin e tyre dhe për më tepër përcaktimin se sa student ka në këtë njësi

Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me standartet shtetërore të cilësisë të ASCAL, në lidhje me programet mësimore, mësimdhënies nga stafi akademik, veprimtarive shkencore e administrative të KU "LOGOS", për plotësimin sa më të mirë të kërkesave të studentëve në pritshmëritë nga shkollimi në këtë institucion (referuar kuadrin ligjor në fuqi).

Në evidencat e KU Logos nuk u gjet dokument i cili rregullon veprimtarinë e NjSBC në nivel institucional dhe NjSBC në nivel fakulteti apo dokument i prioriteteve të sigurimit cilësisë. Relacionet e përvitshme (evidenca bashkëlidhur RVB) të hartuara nga NjSBC, rezultojnë të jenë të paintegruara për të bërë analiza në kuadër institucional.

Në vizitën e GVJ në institucion u bë dhe takimi dhe u diskutua me një pjesë të përfaqësuesve të NjSBC. Në RVB, në tabelen 9, rezulton që nuk përputhet me vendimin e Senatit koha në detyrë e anëtarit student Gjeorgjia Metallari, është prej 2018. Po ashtu, nuk reflektohet në tabelë një anëtar i NjSBC, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, sikundër rezulton në vendimin e Senatit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NjSBC për programin e studimit, si:
  - Sa anketime kanë bërë me studentët
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - Etj

NjBSC, zhvilloi gjatë vitit akademik 2017-2018, në përfundim të simestrit të dytë, në nivel departamenti pyetësorin për pedagogët. Në anketim u përfshinë 48 studentë që ndjekin studimet në Ciklin Bachelor në programin e studimit: "Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë". Pyetësori u plotësua manualisht nga studentët dhe kishte si qëllim të mblidhte informacion në lidhje me performancën e pedagogut në mësimdhënie, mjetet që përdor pedagogu për të qenë më i kuptueshëm, më i qartë në trajtimin e temave në lëndët përkatëse që zhvillon, sa arrin të jetë kërkues në përvetësimin e dijeve nga studentët në lëndën që pedagogu zhvillon, si në aspektin teorik por në veçanti në aspektin praktik të saj. Pyetësori përmban 11 karakteristika për tu vlerësuar nga studenti për pedagogët e programit të studimit Bachelor në "Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë", si dhe për vlefshmërinë e modulit. U përdorën për vlerësimin e





pyetësorit 5 shkallë vlerësimi, ku shkalla 5 ishte shkalla maksimale. Pas vlerësimit sasior të rezultateve të pyetësorit, nga ku u mor feedback nga studentët në lidhje me pedagogët, me maksimumin e koeficientit 5, NjBSC pasi ka përpunuar të dhënat e përfuara nga anketimi, i ka referuar Rektorit dhe është vendosur së bashku për përmirësimin e formularit, i cili do ju vihet në dispozicion studentëve në këtë simestër dhe ku në të cilin janë shtuar 3 pyetje në lidhje me lëndën dhe përmirësimin e mundshëm të saj.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NjBSC, udhëheq kontrollin e brendshëm të cilësisë duke përdorur metodologji të vlerësimit të personelit akademik dhe administrativ, duke analizuar problematikat pas vlerësimit të pyetësorëve, duke propozuar elemente shtesë për të kuptuar të gjitha hallkat që nuk mund të funksionojnë dhe që nevojiten të rregullohen. NjBSC, harton raportin përmbledhës të aktivitetit të NjBSC për tërë vitin akademik 2017-2018 dhe harton plan-parashikimin e veprimtarisë së kësaj njësie për vitin në vazhdim. Ky raport është bashkëlidhur aplikimit.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Tabela, Aneksi 4).

KU "Logos" ka paraqitur disa evidenca lidhur me metodologjitë e vlerësimit të personelit akademik dhe administrativ, por janë të paqarta në mënyrën e analizimit të vlerësimit të tyre.

Në NjBSC, personeli përgjegjës monitoron zhvillimin e tematikave teorike dhe sidomos praktike për çdo lëndë të programit të studimit, plotësimin e tyre në rregjistër sipas planit mësimor të lëndës, si nga ana e stafit të brendshëm të pedagogëve, ashtu dhe të stafit të jashtëm. Monitoron frekuentimin e lëndës, duke kontrolluar në fund të simestrit para mbylljes së lëndës frekuentimin dhe duke mos lejuar të futen në provim studentët që kishin kaluar frekuentimin e lëndës >75% mungesa.

Kryhet monitorimi i procesit të provimit, lidhur me datën dhe orën e zhvillimit të provimit, fletët e provimit nëse mbanin vulën e institucionit apo jo, sqarimet dhe shënimet e pedagogut që ka korrigjuar tezën në përputhje me vlerësimin, nëse informohen studentët për rezultatet se mos ka ndonjë kontestim të vlerësimit nga ana e tyre, plotësimi i procesverbaleve të vlerësimit përfundimtar. Grupi i vlerësimit i raporton pranë Departamentit përkatës dhe kryetarit të NjBSC.

Relacione të grupit të vlerësimit janë bashkëlidhur aplikimit për vitin akademik 2017-2018.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

KU "Logos", me urdhër të Rektorit Nr. Prot. 76/1, datë 27.01.2017, ngriti grupin e ekspertëve të vetëvlerësimit të brendshëm të institucionit të përbërë prej 6 anëtarësh, të cilët hartuan raportin e vetëvlerësimit të brendshëm të institucionit dhe rezultatet e tyre duke u përqëndruar në fushat e vlerësimit si: organizimi dhe menaxhimi i institucionit, burimet në dispozicion të institucionit, kurrikula, mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi i studentëve, kërkimi shkencor, politikat e rregjistrimit të studentëve nga rregjistrimi deri te punësimi i tyre.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Mbi bazën e vetëvlerësimit periodik publikuar në formën e raporteve vjetore institucioni shënjon problematikat e hasura gjatë vitit akademik në të gjitha fushat e vlerësimit, sidomos duke i vënë theksin nxitjes së studentëve për të qenë aktiv në kërkesat e tyre si për përmirësimin e procesit mësimor që të jetë



sa më i aksesueshëm për ta, ashtu dhe për vënien e institucionit në shërbim të tyre për përgatitjen e tyre profesionale që në bankat e shkollës, për të qenë sa më të aftë për kërkesat e tregut të punës. Institucioni i jep shumë rëndësi organizimit të takimeve me pjesmarrje të punëdhënësve, studentëve dhe Alumnit, në mënyrë që të jenë sa më të koordinuar me problematikën e studentëve pasi mbarojnë studimet me tregun e punës dhe në hartimin e strategjive koordinuese për përmirësimin e problematikës, duke e përshtatur sa më mirë studentin me kërkesat e tregut të punës, kryesisht në pasurimin e kurrikulave në përputhje me nevojat e tregut.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> </ol>	<p>KU “ Logos” përdor metodologji vlerësimi të personelit akademik dhe administrativ, instrumenta matës dhe vlerësues për ecurine e programeve të studimit, por këto metodologji janë të paqarta në mënyrën e analizimit të vlerësimit të tyre.</p> <p>Institucioni i publikon në formë raporti vjetor rezultatet e pritshme pas mbledhjes së informacioneve nga anketimet e studentëve, dhe ja komunikon stafit të pedagogëve dhe studentëve, nga të cilët merr dhe mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e procesit të veprimtarisë mësimore. Raporti publikohet dhe në faqen ëeb të institucionit.</p> <p>Institucioni përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta për kryerjen e vlerësimit. Në metodat e tërthorta përdoren, anketimet si dhe intervistat e studentëve, të të diplomuarve, të të punësuarve, etj. Në veçanti u theksua në takimin me përfaqësues të NJSBC që pikënisja për të ndryshuar kurrikulën merret nga të punësuarit.</p> <p>Në metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-analiza e rezultateve të provimit të shtetit në Teknik i Lartë në Laboratorë Mjekësor, ku studentët e KU”Logos”, dolën me rezultate shumë të mira.</li> <li>-vlerësime përgjatë vitit për çdo modul, (15% përkatësisht për çdo simestër), të cilat grumbullohen me pikët e vlerësimit përfundimtar 60%. Po ashtu përgjatë vitit mësimor, pjesmarrja aktive dhe pasive gjatë zhvillimit të modulit zë 10% të totalit të vlerësimit.</li> <li>-praktikat profesionale për çdo student kryhen, mbikqyren dhe vlerësohen nga pedagogu i caktuar</li> </ul>



<p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>për zhvillimin e praktikës apo nga personi përgjegjës pranë institucionit që ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave me KU "Logos".</p>
--	--

### VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

#### Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional dhe në programin e studimit Bachelor në "Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë", me Urdhrin MASH nr.282, datë 04.07.2012, në përputhje me vendimin nr. 338 datë 08/06/2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i saj është kërkesë e vazhdueshme dhe në themel të suksesit të një institucioni dhe arrihet nëpërmjet instrumentave të duhura të vlerësimit të propozuara nga NjBSC dhe të miratuara nga institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Institucioni inkurajon takimet e herëpashershme formale dhe joformale të personelit me studentët me qëllim tërheqjen e opinioneve dhe informimin e studentëve në funksion të sigurimit të cilësisë. Në rol të vecantë në këtë fushë ka dhe Njësia e Këshillimit të Karrierës.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Strategjia për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë është pjesë e strategjisë të zhvillimit të institucionit dhe publikohet në broshurat dhe faqen e internetit të tij.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	
<p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	

#### Konkluzionet e vlerësimit:

1.GVJ konstatoi që nga institucioni i është kushtuar rëndësi sigurimit të cilësisë që në fillesat e institucionit, në vitin 2011 e në vitet më pas kjo njësi është përmirësuar duke u ngritur jo vetëm në nivel institucional por dhe të fakulteteve, dhe me vendimin Nr.43, datë 08.02.2018, është rifreskuar, përmirësuar përbërja e NjBSC, duke u shtuar në nivel institucional një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve, si dhe në nivel fakulteti duke u shtuar një student.

2.Strategjia, politika dhe procedurat që ndiqen për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të publikuara në broshura dhe faqen e internetit. Ato iu prezantohen studentëve dhe në takime formale e joformale me personelin.

3. Mungon plani masave të NjSBC, veprimtaritë e evidentuara, afati, evidenca, personat përgjegjës etj.

4. Gjetjet e GVJ (mungesa e procedurave, pyetësorëve të rinj të miratuar, formulari i vlerësimit të performancës së stafit (nga kolegët dhe përgjegjësi i departamentit) apo analiza/raporte përkatëse për të identifikuar problematika konkrete dhe më pas masat përkatëse për përmirësimin e tyre

5. *GVJ rekomandon, që në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të personelit akademik dhe administrativ,*



*të qartësohet më mirë mënyra e analizimit të vlerësimit të tyre.*

*6. Rekomandohet që pyetësi i studentëve të bëhet nëpërmjet sistemit elektronik (në kushtet kur ofrojnë programe në fushën e IT), duke bërë të mundur përpunimin e të dhënave online në kushte anonimiti, të cilat më pas do të analizohen nga NjSBC në nivel fakulteti dhe Institucioni.*

*Si konkluzion, grupi i vlerësimit rekomandon që NjSBC, si përgjegjëse për cilësinë e institucionit, duhet të bëjë përmirësime në lidhje me organizimin dhe funksionimin e saj.*

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Kolegji Universitar Logos, ka paraqitur në mënyrë të zgjeruar dhe të argumentuar misionin, objektivat e programit të studimit, përmbajtjen e programit të studimit, mënyrën e organizimit, planet mësimore, syllabuset, literaturën e rekomanduar etj.

Programi i ciklit të parë “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga Departamenti “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” pjesë përbërëse e KU Logos. Misioni i këtij programi, i cili përcaktohet në rregulloren e programit (Aneks 3.4.1) është :

- Të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të zhvillojë dijet përmes mësimdhënies dhe këkimit shkencor
- Formimi i specialistëve teknikë të lartë në fushën e Mjekësisë Laboratorike në përputhje me prioritetet e vendit.
- Përzgjedhja e personelit akademik dhe administrativ në përputhje me kërkesat e programit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës me urdhër nr 1 datë 06/01/2010 ka miratuar hapjen e programit të ciklit të parë Bachelor “Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë”

Sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 282 datë 4.07.2012 bazuar në vendimin Nr.338 datë 8.06.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, SHLP Logos ka akredituar për një periudhë 6 vjecare, programet e ciklit të parë në përfundim të të cilave lëshohet diploma “Bachelor” në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë.

Me urdhër të Ministrisë së Arsimit nr 479 datë 16/12/2015 emërtimi i

programit Bachelor “Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë” u ndryshua në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”





Misioni i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë është përgatitja e studentëve me njohuri për teknikat bazë në fushat e Mjekësisë Laboratorike: Kimi Klinike, Hematologji, Mikrobiologji dhe Histopatologji.

Objektivat e programit të studimit “Bachelor” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë janë:

- Përgatitja profesionale si teorike ashtu dhe praktike në lidhje me teknikat bazë të cilat aplikohen në laboratorët mjekësorë.
- Përgatitja e specialistëve për laboratorët mjekësorë, të aftë për të njohur dhe përdorur teknologjinë e aparaturave bashkëkohore të laboratorëve mikrobiologjikë, biokimiko-klinikë dhe të histopatologjikë.
- Krijimi i figurës së teknikëve ekspertë në fushën e laboratorëve, i aftë për të kryer analiza me cilësi të lartë në funksion të shërbimit ndaj pacientit.
- Hapja e perspektivës për të diplomuarit në Bachelor në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë, që me disa plotësime të kenë mundësi të regjistrohen në ciklin e dytë të studimeve, mastet profesional ose master shkencor.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit ka qënë i organizuar në 3 vite akademike, 6 semestra me 90 javë mësimore në auditor dhe me 180 ECTS në total. Me riorganizimin e strukturës, programi që është paraqitur për akreditim është i organizuar:

- Në 1 vit akademik: 30 javë mësimore në auditor
- Në 2 semestra: cdo semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Numri total i krediteve të programit është 180 ECTS
- 1 orë mësimore – 50 minuta
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë Bachelor, me emërtimin: **Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.**

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela e Planit ne aneks)

Në planet mësimore dhe syllabuset është paraqitur numri total i ECTS-ve për çdo lëndë dhe ndarja e orëve mësimore sipas tipit të mësimdhënies. ***Nuk jepet ndarja e ECTS-ve sipas formave të mësimdhënies për vitin aktual akademik por vetëm për vitin e licensimit.*** Panvarësisht kësaj mungëse në informacion, ***GVJ ka bërë kategorizimin dhe vlerësimin në bazë të programit të vitit akademik 2018-2019.*** Nga të dhënat e tabelës dhe të planeve mësimore konstatohet përputhëje e numrit të orëve me ECTS në gjitha lëndët, duke qënë në zbatim të udhëzimit të MASH. Në planin mësimor 53% e ECTS-ve i përkasin disiplinave të formimit karakterizues (B), rreth 16% e ECTS-ve i përkasin disiplinave të formimit të përgjithshëm (A), rreth 11% e ECTS-ve i përkasin lëndëve ndërdisiplinore/integruese (C), rreth 15 % e ECTS-ve i përkasin lëndëve plotësuese (D), rreth 3% e ECTS-ve i përkasin detyrimeve plotësuese. Panvarësisht se kategorizimi tenton të jetë brenda kufinjve në përqindje të përcaktuar nga udhëzimi Nr. 41 i MASH, ***sugjerojme që të ulen ECTS në disiplinat plotësuese dhe të rriten në lëndet ndërdisiplinore/integruese.***

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10 orë në auditor /15 orë punë e pavarur e studentit



- Për Seminaret 10 orë në auditor /15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 10 orë në auditor /15 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar/Pregatitja e temës së Diplomës 35 orë në auditor dhe 140 orë punë e pavarur e studentit

Përcaktimi i krediteve sipas formës së studimit është bërë në mënyrë korrekte në bazë të udhëzimit të MASH, por ky udhëzim nuk është zbatuar për të gjitha lëndët në rastin e ndarjes së veprimtarisë *formuese brenda lëndës, ku numri i kredive që i përkasin leksioneve, duhet të përbehet jo me pak 50% e krediteve totale.*

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Plani mësimor i ciklit të parë Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë që është paraqitur për akreditim **ka ndryshime të rëndësishme** krahasuar me planin mësimor të akredituar për herë të parë . Ndryshimet e planit nga njëri vit në vitin tjetër, janë pasqyruar në RVB por nuk është plotësuar tabelë përmbledhëse , për të diferencuar programin e akredituar me planin aktual.

Pas vizitës në institucion, na u vu në dispozicion tabela 12 e plotësuar edhe për vitin akademik 2018-2019, në këtë tabelë konstatohen ndryshimet e mëposhtëme:

- Ndryshimet më të rëndësishme gjatë gjashtë viteve, në planin mësimor janë bërë në vitin akademik 2012-2013, një vit pas akreditimit të parë të parë të programit, këto ndryshime gjykohen nga GVJ krejtësisht të justifikuara dhe kanë konsistuar në:

- Uljen në total të numrit të orëve të disa moduleve si Biosiguria, Bakteriologjia, Biokimia, Mikrobiologjia, Hematologjia etj. me qëllim ruajtjen e kriterit të 20-25 orëve mësimore në auditor.

- Heqjen e disa lendeve apo zhvendosjen e tyre në ciklin e dytë të studimit “Master Profesional” si Terminologji Mjekësore, Shendet Publik, Legjilacion Mjekësor, Etike Komunikimi.

Shtimin e lëndëve Kimi organike , Kimi inorganike dhe Psikologji Mjekësore.

- Ndryshimet kanë vazhduar në vitin akademik 2013-2014, këto ndryshime kane konsistuar kryesisht në ndryshim e oreve në auditor dhe në ndryshimin e krediteve të lëndeve ekzistuese.

- Ndryshimet në program nga viti akademik 2014-2015 deri 2017-2018 konsistojnë në vetëm dy lëndë, me ndryshim kreditesh dhe orësh në auditor.

- Ndryshimet në programin e vitit akademik 2018-2019 krahasur me vitin paraardhës dhe plan syllabuset përkatëse nuk ishin të përvshira në RVB por janë vënë në dipozicion si dokument të vecanta pas kërkesës së GVJ. Ndryshimet në planin mesimor për dy vitet e fundit nuk janë thelbosore, ato konsistojnë vetëm në ndryshimin e orëve në auditor, pa prekur numrin e krediteve, ndryshimin e lëndëve apo organizimin e programit sipas semestrave.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotëso Tabelën ne Aneks)

Personeli akademik që mbulon aktualisht programin Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përbëhet përgjithësisht nga personalitete me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse. *Në një rast fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar duke ndikuar direkt në cilësinë e mësimdhënies. Lenda Biokimi Mjekësore sugjerojmë të jepet nga Mjekë Specialistë të Laboratorit.*

*GVJ vë re një lëvizje të madhe të personelit akademik në vitet pas licensimit, këto lëvizje kanë prekur kryesisht personelin me kontaktë, ndërsa përsonelele efektiv ka pësuar kryesisht ndryshime në numër. Një*



situatë e tillë mund të shpjegohet me përpjekjet e institucionit për të rritur numrin e personelit akademik efektik dhe shkurtuar atë me kontratë, vëme re që personeli me kontratë i cili mbulon aktualisht programin është i përgjithësisht rekrutuar rishtas, **ai përbëhet nga mjekë me kompetencë dhe të kualifikuar në fushën përkatëse.**

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit

Janë deklaruar të dhënat lidhur me emërtimet e cdo lënde dhe moduli; sugjerojmë ndryshimin e emërtimit për lëndën: Njohuri Formimi Profesional në Njohuri të Teknikave në Laboratorët Mjekësorë. **Ka mos përputhje emërtimi të kësaj lëndë në program me syllabuset.**

- Viti/semestri kur zhvillohet lënda

Eshtë deklaruar qartë viti/semestri ku zhvillohet lënda

- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën

Eshtë deklaruar emri i titullarit dhe i pedagogut që do të zhvillojë lëndën.

- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit

Eshtë deklaruar qartë në syllabus vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit.

- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës

Për secilën lëndë janë dhënë qartë kushtet për njohuritë paraprake.

- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë

Cdo program lënde është shoqëruar me një përmbledhje të aftësive, njohurive dhe kompetencave që lënda i jep studentit.

- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik

Tematikat janë përshkruar në mënyrë të detajuar sipas formave të mësimdhënies dhe orëve përkatëse për secilën temë. **Në disa syllabuse nuk është zbatuar formati sipas vendimit nr 41, dt 24.1.2018 i MASH ku përfshihet dhe numri faqeve në literaturë.**

- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS

Në planin mësimor është dhënë numri i orëve në auditor dhe jashtë auditorit për secilën lëndë të programit studimor. Në cdo syllabus shpërndarja e orëve sipas formave të mësimdhënies është paraqitur në formë tabelare. **Në lëndët Hematologji 2 dhe Analizë e lëngjeve biologjike ka mospërpudhje në numrin e orëve më programin mësimor.**

- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre

Janë deklaruar format dhe metodat e mësimdhënies dhe raportet mes tyre.

- Format e vlerësimit të studentëve

Eshtë paraqitur mënyra e vlerësimit të studentëve shoqëruar dhe me sqarimet përkatëse.

- Detyrimet e studentit për lëndën



Në rregullore, në planin mësimor dhe në syllabuse janë përcaktuar detyrimet e studentit për lëndën.

**Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse**

Për pothuajse cdo lëndë është deklaruar literatura. Në të paktën një lëndë literatura e detyrueshme është në gjuhë të huaj. (Analiza e Urinës dhe Lengjeve Biologjike). Sugjerojmë që në lëndën Njohuri të Formimit Profesional, literatura bazë në shqip të ndryshojë pasi e gjykojmë të papërshtatshme. Një pjesë e literaturës është e vjetëruar dhe ka lëndë të cilat përdorin të njëjtën literaturë bazë.

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Tematikat e syllabuseve janë në përgjithësi bashkëkohore dhe në koherencë me programin e studimit. Syllabuset janë aprovuar nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Literatura i një pjese të syllabuseve duhet përmirësuar.

- *Një pjesë e syllabuseve nuk i përmbahen standartit duke përshkruar të dhëna teorike të panevojshme në tëmat përkatëse.*
- *Pas vizitës në institucion në një pjesë të syllabuseve të përditësuar në sistem, janë venduar si literature edhe lëksione të pedagoqeve por GVJ*
- *nuk ka pasur mundësi ti verifikoi. Sugjerojmë që në dispozicion të studentëve, kryesisht në lëndët karakterizuese, të vendoset literaturë e shkruar në formë të broshurave nga lektorët dhe e depozituar në departament dhe bibliotekë.*

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Në institucion u konsultuan dhe një herë syllabuset e lëndëve, programet mësimore dhe na u vunë në dispozicion dokumente plotësuese mes të cilave një dokumenti kerkesë i departamentit përkatës, për ndryshime të kurrikulës për vitin e ardhshëm akademik. *Ndryshimet e kërkuara, konsistojnë kryesisht në shpërndarjen e lëndeve në semestra, heqjen e gjuheve të huaja Anglisht III, IV dhe Greqisht III,IV dhe ndryshime në shpërndarje kreditesh.* GVJ i gjykon këto ndryshime krejtësisht të arsyeshme, në funksion të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë, gjithashtu në funksion të këtij qëllimi GVJ sugjeron:

- Uljen e krediteve në lëndët Kimi inorganike dhe organike.
- Uljen e krediteve të lendeve Sigurim Teknik dhe Biosiguri, ose realizimin në një modul të kombinuar.
- Të shikohet mundësia e shtimit të temave të Biofizikes dhe Optikës ndoshta në një lëndë të vecantë.
- Të futët si lëndë e vecantë ose cikël leksionesh Automatimi në Laboratorët Mjekesorë dhe Sistemet e Informatizimit Laboratorik (LIS)

*GVJ thekson se të gjitha syllabuset mbi të cilat ë shtë bërë vlerësimi janë vë në dispozicion pas vizitës dhe konsultimeve në institucion.*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara	KU Logos, ofron programe studimi të ciklit të parë



të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);

**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;

“Bachelor” të akredituara dhe të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Institucioni ka paraqitur për akreditim programin e studimit Bachelor të organizuar në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi Master Profesional me kohë të plotë është 60 kredite.

## II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

### Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

**Kriteri 1** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

**Kriteri 3** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

**Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Departamenti përgjegjës i programit Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë vë në dispozicion informacionet e nevojshme për programin e studimit ndërmjet : Guidës së Studentit, informacionit në ambjentet e kologjit dhe faqes ëeb (Aneks 4.4.7). Departamenti jep informacionin e nevojshëm për lëndët e detyruara, lëndët më zgjedhje, ngarkesën mësimore, frekuentimin, praktikatat dhe orët laboratorike. Informacioni i verifikua gjatë komunikimit me stafin dhe studentët.

### Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit është në përputhje me misionin dhe objektivat specifike si dhe përshtatet me nevojat e tregut të punës. Programi është strukturuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi si dhe direktivat e BE për arsimin e lartë. Ai realizohet në kohëzgjatje normale prej një viti dhe 180 ECTS.
2. *Në planin mësimor shpërndarja e krediteve për forma të ndryshme të mësimdhënies, është zbatuar në mënyrë të saktë.*
3. Personeli akademik që mbulon aktualisht programin Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë përbëhet përgjithësisht nga personalitete me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse. *Në një rast fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar duke ndikuar direkt në cilësinë e mësimdhënies. Vihet re një lëvizje e konsiderueshme e personelit akademik kryesisht atij me kontratë.*
4. Në vitet pas akreditimit të parë programi ka pësuar ndryshime të rëndësishme, *megjithatë GVJ*



*sugjeron ndryshime të mëtejshme në program, futje lëndësh apo ciklesh të reja në funksion të rritjes së cilësisë. Kategorizimi i disiplinave është bërë në menyrë të saktë megjithatë **GVJ sugjeron rishikimin e shpërndarjes së krediteve në raport me format e mësimdhënies duke ulur ECTS në disiplinat plotësuese dhe rritjen në lëndet ndërdisiplinore/integruese.***

5. Syllabuset janë në përputhje me misionin dhe objektivat e programit të studimit. **GVJ sugjeron ndryshimin emërtimit në një nga lëndët dhe futjen e literaturës në formë të broshurave të përpiluara nga lektorët me qëllim rritjen e cilësisë dhe rishikimin e disa prej syllabuseve.**

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në programin e studimit “Bachelor” në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”, procesi i mësimdhënies është i shtrirë në tre vite akademike, me një total kreditesh 180 kredite. Mësimdhënia është e organizuar në formën e leksioneve, seminareve, laboratoreve, praktikave lëndore në auditor, praktikave profesionale, testeve të ndërmjetme gjatë vitit akademik për të kontrolluar përgjatë gjithë vitit njohuritë e studentëve. Viti akademik ka ngarkesë mësimore prej 15 javë mësimore për çdo simestër dhe 24 orë javore fizike, në përputhje me kërkesat e ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Departamenti e ka përshtatur planin mësimor bazuar dhe në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ku disiplinat mësimore u grupuan në 5 (A-E) nga 6 (A-F), që ishin më parë dhe u përshtatën syllabuset sipas formatit të kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.1.2018

I jepet përparësi në mësimdhënie trajtimit dhe shpjegimit të temave të moduleve nga ana e personelit akademik, në mënyrë sa më të thjeshtë e të kuptueshme për studentin. Për zhvillimin e leksionit ishin në dispozicion mjete bashkëkohore për zhvillimin e tij, si psh mjetet audiovizive, etj. Ora e seminarit, organizuar më së shumti në formën pyetje përgjigje bën të mundur dhe nxitjen e debatit në shtjellimin e temave të ndryshme. Në takimin me personelin akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme gjatë vizitës në institucion dhe gjatë shqyrtimit të CV të tyre konstatuam se pjesa më e madhe e tyre janë personel akademik me eksperiencë të gjatë e me kontribut të shquar ndër vite në arsimimin e brezave të rinj në mjekësi, e në veçanti në mjekësinë laboratorike. Kjo përbën një garanci për një cilësi më të lartë në mësimdhënie, si dhe një mbështetje dhe ndihmë për trajnimin e pedagogëve të rinj, që rekruton institucioni. U theksua nga ana e pedagogëve përparësia që duhet të marrë gjithnjë e më shumë pjesa praktike laboratorike në lëndët bazë laboratorike, në mënyrë që të plotësohet rreth 80% e njohurive që marrin në teori, në aplikimin në punën në laborator nga ana e vet studentëve.

Po ashtu, u theksua nga ana e pedagogëve që vazhdimisht ata ndjekin nevojat e tregut për përmirësimin e kurrikulave, psh me rritjen e patologjive tumorale bëhet e nevojshme rritja e trajtimi i një tematike më të zgjeruar në histopatologji, laborator i së cilës është i pajisur më së miri për të plotësuar këtë kërkesë të re të tregut.



U evidentua gjatë vizitës në institucion që teknologjia dhe paisjet laboratorike që laboratorët e KU “Logos” dispononin në mbështetje të mësimdhënies ishin të mjaftueshme e cilësore. Psh, për çdo student ishte në dispozicion nga një mikroskop për praktikat e hematologjisë dhe të histopatologjisë, apo paisje ndihmëse laboratorike në dispozicion për çdo dy student në kryerjen e praktikave laboratorike. Kjo i ndihmon shumë studentët që të përvetësojnë sa më mirë elementët e praktikës.

Nga NJSBC zhvilloheshin herë pas here ndjekje të procesit mësimor, për të parë nga afër mënyrën e mësimdhënies për secilin pedagog, a shfrytëzohej në maksimum ora e mësimit për të shpjeguar sa më mirë temën e ditës dhe të kërkohej nga studentët nëse kishin ndonjë paqartësi, në mënyrë që ata të mos largoheshin nga ora e mësimit të pasqaruar, në lidhje me shpjegimin. Po ashtu, NJSBC merrte feedback nga ana e studentëve për procesin e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve.

Në lidhje me kontrollin e njohurive, studentët informohen në fillim të vitit mësimor sesi është modeli dhe formula e kontrollit, sipas përcaktimit në syllabusin e çdo lënde.

*Rekomandohet të shihet mundësia që në disa lëndë përveç provimit me shkrim, të zhvillohet dhe provim me gojë, për të pajisur studentin me aftësi të komunikimit të ndërsjellë.*

*Rekomandohen trajnime didaktike paraprake për çdo formë të re të mësimdhënies.*

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela e Planit ne aneks):  
Bazuar në Tabela 9, në aneksin e RVJ, paraqet orët totale korrekte në auditor në përputhje me planin mësimor për vitin akademik 2018-2019, programi studimit BA TLLM. Nuk përputhen të dhënat e paraqitura në tabelën 14 të RVB bashkëlidhur aplikimit, të cilat nuk i përkasin vitit akademik 2017-2018, por 2018-2019. Nr. orëve të seminareve sipas përllogaritjes janë 550 orë, jo 585 orë, sic është paraqitur në tabelën 14, te RVB (RVB, tab.14, faqja 87). Për vitin 2017-2018, orët totale në auditor rezultojnë 2100, plus 35 orë diploma, japin total 2135 orë. Për vitin 2018-2019, me ndryshimet që bëri Departamenti planit mësimor, për t’iu përshtatur VKM Nr.41, datë 24.01.2018, rezulton orë totale në auditor 1730, plus 35 orë diploma, shkon 1765 orë në total, aq sa është dhe shuma në tab.14.

- Leksione 770 orë
- Seminare 550 orë
- Laboratore 325 orë
- Praktikë lëndore 85 orë
- Diploma 35 orë
- Etj.

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive janë të organizuara për gjatë gjithë vitit shkollor, duke u ndarë përkatësisht, në ndjekjen e lëndës dhe pjesmarrjen aktive gjatë orës së mësimit në masën 10%, në testimet gjatë vitit akademik në masën 30%, dhe në provimin përfundimtar të lëndës së zhvilluar në masën 60%.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj



Sipas RVB studentët angazhohen kryesisht në punime shkencore individuale të pedagogëve. Sipas takimit me një përfaqësi të studentëve gjatë vizitës në institucion studentët e vitit të II-të dhe të III-të u shprehën për angazhimin e tyre në organizimin e konferencave studentore.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

*Gjatë vizitës në institucion u konsultuan planet mësimore, ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe u kërkua që ti vihej në dispozicion grupit të vlerësimit plani i ndryshuar mësimor 2018-2019 dhe përshtatja e syllabuseve të lëndëve, sipas formatit të kërkuar nga VKM nr.41, datë 24.01.2018*

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve bazohen në kriteret e përcaktuara nga MASH dhe në rregulloren e programit të studimit dhe në nenet përkatëse të transferimit të studentëve.

Institucioni për vitet akademike 2016 – 2017 dhe 2017-2018 ka vendosur kritere shtesë për pranimin e studentëve, më vlerësim të notës mesatare në grup lëndësh, ndërsa për pranimet në vitin akademik 2018-2019 departamenti nuk e ka konsideruar aplikimin e tyre. Gjykojmë që mos aplikimi i kritereve shtesë ka rritur numrin e regjistriteve nga 7 studentë për vitin akademi 2017-2018 në 26 studentë për vitin akademik 208-2019. Viti akademik me numrin e regjistriteve më të larta është viti 2015-2016, dhe me numrin më të ulët vitin 2017-2018. Nota mesatare varion nga 6.05 në 8.3. Në vitin aktual akademik vihet re një mesatare e lartë note e studentëve të regjistruar.

Institucioni ka përcaktuar në rregulloren e programit detyrimet akademike të studentit. Programi është me kohë të plotë dhe afati i studimeve është dyfishi i afatit të rregullt duke marrë në konsideratë vetëm periudhën kur studenti ka qënë i regjistruar në vit akademik. Studenti kalon në vitin pasardhës kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të vitit paraardhës, rregulli vlen edhe për procesin e transferimeve.

Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ raportet vjetore të veprimtarisë së institucionit nga viti 2012 deri në vitin 2018 në cilat bëhet analizë e rezultateve të procesit mësimor për të tre vitet e programit Bachelor.

Kalueshmëria e studenteve paraqitet mjaft e lartë mbi 92% -98% dhe nota mesatare nga 6.65- 7.08. Vihet re një notë më e ulët mesatare në lëndës integruese /ndërdisciplinore. Bie në sy nota mesatare mjaft e lartë e studentëve që e kanë përfunduar ciklin e studimit me temë diplome (9.5 në vitin shkollor 2015 – 2016 dhe 9.8 në vitin shkollor 2016 – 2017) kundrejt një note mesatare të ulët për studentët që kanë përfunduar ciklin e studimeve me provim (5.62 në vitin shkollor 2015 – 2016 dhe 6.6 në vitin shkollor 2016 – 2017). Numri në rritje i regjistriteve si dhe kalueshmëria e lartë janë tregues të interesit që kanë studentët për këtë program studimi.

KU Logos është përpjekur të krijojë një database për punësimin e studentëve të ciklit të parë dhe të programit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. Nga studentët e kontaktuar që kanë përfunduar programin Master Profesional 31% rezultojnë të punësuar në përputhje me diplomën, KU





thekson se të dhënat nuk janë të plota pasi vetëm një pjesë e studenteve janë kontaktuar. Rezultatet janë në plotësim dhe përpunim.

KU Logos mban komunikim me ish studentët e diplomuar; në nëntor 2017 është organizuar dhe rrjeti ALUMNI Logos (dokumenti na u vu në dispozicion në takim në institucion). Këshilli studentor dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës luajnë rol të rëndësishëm në informimin e studentëve dhe këshillimin e tyre. Këto elementë janë parashikuar në dokumentet rregullatore të institucionit pranë Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Dokumentacioni na u vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion.

### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

#### 1- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve në programin Bachelor “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” bazohet në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Në programin e studimit Bachelor Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë pranohen kandidatë që:

- Kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm me note mesatare mbi 6
- Zotërojnë një diplomë të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë brënda ose jashtë vendit.
- Diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të ekuivalentuar me diplomën e maturës shtetërore.

***Institucioni nuk ka konsideruar vendosjen e kriterëve shtesë për pranimin në këtë program studimi.***

#### 2- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Vlerësimi i cilësisë së studentëve në hyrje dhe dalje të programit të studimit realizohet duke marrë në konsideratë dhe duke krahasuar rezultatet e arsimit të mesëm me rezultatet e studentit të diplomuar.

**Institucioni nuk ka vendosur në dispozicion të dhëna.**

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela në aneks)

- 36 studentë në vitin akademik 2012 – 2013 /7.09
- 18 studentë në vitin akademik 2013 – 2014 /6.05
- 31 studentë në vitin akademik 2014 – 2015/8.31
- 72 studentë në vitin akademik 2015 – 2016 /7.63
- 39 studentë në vitin akademik 2016 – 2017 /6.62
- 7 studentë në vitin akademik 2017 – 2018 /6.58
- 26 studentë në vitin akademik 2018 – 2019/ 8.3

Viti akademik me numrin e regjistrimeve më të larta është viti 2015-2016, dhe me numrin më të ulët vitin 2017-2018. Notaa mesatare varion nga 6.05-8.3. Vitin aktual akademik vihet re një mesatare e lartë note e studentëve të regjistruar.

#### 3- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

- 49 studentë në vitin akademik 2012 – 2013
- 37 studentë në vitin akademik 2013 – 2014
- 18 studentë në vitin akademik 2014 – 2015
- 29 studentë në vitin akademik 2015 – 2016
- 29 studentë në vitin akademik 2016 – 2017
- 54 studentë në vitin akademik 2017 – 2018

**Nuk ka të dhëna për notën mesatare**





Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend  
Institucioni parashikon mobilitet të studentëve drejt institucioneve të tjera ose nga institucionet e tjera në vend. Institucion ofron njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi ose programeve të ngjashme. Transferimi njihet vetem brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha të njëjta ose të përafërta. Departamenti pergjegjes në bazë të udhëzimeve të MASH nge komisionin Ad Hoc për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve. Gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion dhe na u sqarua praktika e transferimeve.

Të dhëna për punësimin e studentëve  
KU nuk ka ende një databasë të plotë për punësimin e studentëve. KU Logos është përpjekur të krijojë një database për punësimin e studentëve të ciklit të parë në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë por nuk ka arritur të marrë të dhëna të plota për shkak të mobilitetit të lartë ndërprerjes së kontaktëve. Institucioni mendon që venia në fuksionin e rrjtit ALUMNI dhe fuqizimi i tij do krijojë mundësinë e marrjes së informacionit më të plotë.

Numri total të diplomuarve  
Numri total i të diplomuarve gjatë viteve 2013 deri 2018 është 216 .

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)  
Nga studentët e kontaktuar që kanë përfunduar programin Bachelor 68 studentë ose 31% e totalit, rezultojnë të punësuar në përputhje me diplomën. Të dhënat i përkasin viteve të diplomimit nga 2013 deri në 2018. Rezultatet janë në plotësim dhe përpunim.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

**Nuk ka të dhëna**

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë pranoen studentë me notë mesatare mbi 6 dhe që kanë përfutuar një nga diplomat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mature shtetërore</li> <li>- Diplomë e shkollës së mesme (të përgjithëshme ose të profilizuar) sistemi I vjetër.</li> <li>- Diplomë eshkollës së mesme professional 5 vjecare</li> <li>- Deftesë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barazvlefshme në Shqipëri.</li> <li>-</li> </ul> <p>Institucioni nuk ka përcaktuar kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve në këtë program</p>



	studimi.
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët janë informuar në mënyrë të detajuar për përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë, afatin e përfundimit, mënyrën e organizimit stadin e procesit të akreditimit, kjo na u tha gjatë takimit që patëm me studentët e këtij programi studimi. Institucioni ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës që iu jep informacion studentëve për mundësitë e punësimit. Praktika profesionale në klinika e laboratorë i njeh direkt studentët me kërkesat e punësimit. Me vendim të Senatit të SHLP Logos, që nga fillimi i vitit akademik 2014 – 2015, funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës që siguron informacion dhe trajnime për studentët. Kjo zyrë organizonte edhe takime me studentët, ku ata njiheshin me konferencat apo aktivitetet e tjera që mund të organizonte IAL.</p>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programin e studimit të ciklit të parë</p> <p>Institucioni disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar transferuar në programin e studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.</p> <p>Institucioni disponon një bazë të plotë të dhënash për ecurinë akademike të studentëve që nga momenti i regjistrimit. Për vitin në vazhdim të dhënat nuk janë të plota pasi nuk ka përfunduar diplomimi.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Në funksion të këshillimit të studentëve, asistencës për problematika që lidhen me procesin mësimor, në KU Logos funksionon jo vetëm Zyra e Këshillimit të Karrierës por dhe Zyra e Etikës dhe Qendra e Kërkimit Shkencor. Në këtë proces janë të përfshirë aktivisht dhe anëtarët e stafit akademik. Praktikant profesionale jashtë institucionit nuk janë të parashikuara në këtë</p>



program studimi, megjithatë në rastet kur kërkohet nga studentët , Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) i orienton dhe rekomandon në qendrat mjekësore ku kërkojnë të kryejnë praktikë profesionale.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Informacioni në lidhje me studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është i evidentuar qartë në statutin dhe rregulloren e KU Logos si dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.
2. Studentët janë vazhdimisht nën kujdesin e stafit akademik dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës lidhur me komponentët e procesit mësimor dhe të punësimit të ardhshëm.
3. Në institucion funksionon rrjeti ALUMNI Logos dhe Këshilli studentor që japin ndihmesën e tyre në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në zgjerimin e informacionit për tregun e punës dhe mundësitë e mobilitetit.
4. Institucioni përgatit raporte vjetore për arritjet dhe problematikat e procesit mësimor, të paisur me tabela dhe grafikë për vitin dhe krahasuese mes vitesh.
5. Institucioni ka krijuar një database për punësimin e studentëve i cila është në përditësim .

### **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

#### **10. Kërkimi shkencor** **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmartja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor përbën një komponent të rëndësishëm në strategjinë e institucionit, që në hapat e para të formimit të tij ashtu dhe në hartimin e strategjive afatgjata. Për kërkimin shkencor është krijuar një strukturë brenda KU "Logos", e cila është Qendra e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit. Kjo qendër, në vitin akademik 2016-2017, u aprovua si njësi bazë pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe është e përbërë nga një staf prej 6 anëtarësh. Kjo qendër miraton strategjinë bazë të kërkimit shkencor në bashkëpunim me Fakultetet e KU "Logos". Kjo strategji miratohet nga Senati i KU "Logos" dhe ju përcillet të gjitha departamenteve. Stafit akademik është i angazhuar në projekte kërkimore dhe botime shkencore dhe KU "Logos" boton revistën e vet shkencore "LOGOS". Nga ana e institucionit ka mbështetje të mjaftueshme financiare në drejtim të veprimtarisë kërkimore shkencore të institucionit, aktiviteve shkencore të organizuara nga KU "Logos", si psh seminareve trajnuese, konferencave ndërkombëtare, konferencave studentore, leksioneve të hapura për mësimdhënien dhe mësimnxënien, për përdorimin e teknologjisë në edukim, etj. U theksua gjatë takimeve në institucion që nga ana e





institucionit mbështetet dhe inkurajohet stafi akademik jo vetëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies por në veçanti të integritit të kësaj veprimtarie me veprimtarinë kërkimore shkencore, për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë vendit të stafit akademik, për botime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik pranë universiteteve jashtë vendit me të cilat KU"Logos" ka marrëveshje bashkëpunimi. Integrimi i veprimtarisë kërkimore shkencore me atë të mësimdhënies përbën një prioritet të rëndësishëm për institucionin për tu zhvilluar e çuar përpara. Po ashtu në takim me përfaqësues të qendrës së kërkimit shkencor u vu theksi dhe në angazhimin dhe aktivizimin e studentëve në punime shkencore të stafit akademik, për të dhënë një kontribut sado modest në mënyrë që ata të ndjehen të përfshirë dhe të angazhuar në veprimtarinë kërkimore-shkencore të institucionit. U theksua që studentët e programit Bsc në TLLM nuk e kanë në program lëndën e metodologjisë së kërkimit shkencor, por ata angazhohen në punimet shkencore të stafit akademik, që të japin kontributin e tyre në veprimtaritë shkencore të organizuara nga KU"Logos". Po ashtu inkurajohen studentët me rezultate më të mira në përgatitjen e temave të diplomave, duke kryer një punë të mirëfilltë studimore praktike në laborator, brenda KU"Logos", ose në bashkëpunim me institucionet me të cilat KU "Logos" ka marrëveshje bashkëpunimi. Shkrimet më të mira të studentëve nga temat e diplomave botohen në revistën shkencore të studentëve të KU "Logos". Po ashtu, evidentuam gjatë takimeve në institucion që është bërë një punë e lavdërueshme për ngritjen e nivelit shkencor të studentëve duke u ofruar njohjen me teknologjinë bashkëkohore përmes bashkëpunimit ndërinstytucional, si psh, bashkëpunimi me laboratorin mjekësor "Intermedica", ku studentët janë njohur nga afër me teknikat dhe të rejat e fundit të teknologjisë në fushën e mjekësisë laboratorike.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor ( Tabelat ne aneks)

Janë 76 botime në total si poster apo artikuj në revista shkencore, nga stafi akademik efektiv. Në drejtim të aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL për programin e studimit të TLLM, ku deri së fundi janë zhvilluar 9 aktivitete, 34 numri i pjesëmarrësve, synohet që në të ardhmen jo vetëm të shtohet numri i tyre, por të zgjerohet dhe tematika, sidomos duke pasur në fokus zhvillimet e vullshme të teknologjisë të viteve të fundit në mjekësinë laboratorike, siç psh ishte seminari me temë: "Aplikimi i Teknologjisë Bashkëkohore në Mjekësinë Laboratorike". Ndër aktivitetet kryesore që mund të përmendim janë: Konferenca e I-rë Ndërkombëtare "Current Developments and Neë Perspectives in Applied Sciences and Economy", 17 mars 2017, organizuar nga KU "Logos" në bashkëpunim me Universitetin Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë", Universitetin e Mjekësisë, Tiranë; Universitetin e Pireut, Greqi dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës". Konferenca e II-të Ndërkombëtare në Shkencat e Aplikuara dhe Ekonomi, 20 prill 2018, organizuar nga KU "Logos" në bashkëpunim me Universitetin Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë", Universitetin e Mjekësisë, Tiranë; Universitetin e Pireut, Greqi, Universitetin "Sancti Cyrilli", Maltë dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës".

Po ashtu janë zhvilluar dy Konferenca Studentore e I-rë dhe e II-të, në Shkencat e Aplikuara dhe Ekonomike, të cilat patën interes të madh nga ana e studentëve. Prezantimet ishin paraqitur, nën udhëheqjen e stafit akademik të KU "Logos", ishin me tematikë bashkëkohore. Përsa i takon kërkimit shkencor me procesin mësimor rezultojnë në total 10, ku ky numër i përket kryesisht stafit efektiv dhe është realizuar përgjatë viteve akademike 2016-2017 dhe 2017-2018. 27 është numri total i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor nga viti 2016-2018, e këta student janë të angazhuar jo drejtpërdrejt në





kërkimin shkencor, por duke kontribuar në pjesën organizative të tij. Sipas takimit me një përfaqësi të studentëve gjatë vizitës në institucion studentët e vitit të II-të dhe të III-të u shprehën për angazhimin e tyre në organizimin e konferencave studentore.

Përsa i takon projekteve kërkimore të fituara si dhe të zbatuara në programin e studimit në TLLM, nuk ka. Po ashtu dhe Çmime Kombëtare, nuk ka. Qendra e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit është e interesuar dhe e angazhuar për tu bërë pjesë e aplikimeve për pjesëmarrje në projekte kërkimore.

Qendra e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit pranë KU "Logos" do vazhdoj të hartoj e zbatoj strategji të reja, të qarta e të integruara të veprimtarisë kërkimore-shkencore që ajo të jetë sa më bashkëkohore. Nga ana e Fondacionit "LOGOS", i është dhënë gjithmonë përparësi mbështetjes financiare për të nxitur dhe zhvilluar dhe më tej kërkimin-shkencor e kjo do vazhdoj dhe në të ardhmen.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

KU "Logos", për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor ka vendosur komunikime dhe bashkëpunime me universitete brenda dhe jashtë vendit, si psh Universiteti Katolik "Zonja e Këshillit të Mire", Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Ëestern Macedonia si dhe Universiteti i Pireut në Greqi, Universiteti Sancti Cyrilli A.D 1669, Maltë, Universiteti i Oradea, Rumani.

Drejtimet kryesore të bashkëpunimit me këto Universitete janë:

- organizime të përbashkëta të aktiviteteve shkencore, konferencave, ëorkshopeve, trajnimeve, leksioneve të hapura
- shkëmbimeve të informacionit kërkimor-shkencor
- shkëmbimeve dhe pjesëmarrjeve të stafit akademik në eksperiencën mësimore
- pjesëmarrje të studentëve në programin ERASMUS +
- dhënie bursash për studentët më të mirë
- pasurimi i bibliotekës, etj.

Disa prej drejtimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit ende nuk janë konkretizuar por institucioni është i angazhuar plotësisht në përmbushjen e të gjitha drejtimeve të bashkëpunimit me universitetet me të cilat janë rinovuar marrëveshjet e bashkëpunimit.

KU "Logos", për ngritjen profesionale të studentëve, sidomos nga ana e praktikës laboratorike ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa qendra laboratorike mjekësore private dhe shtetërore, si psh





Laboratori “Intermedica”, Fondacioni Klinika Orthodoxe e Ungjillëzimit, Spitali Hygeia, Shërbimi i Mikrobiologjisë pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Shërbimi i Laboratorit pranë Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Biochek Diagnostic Center, GENIUS SHPK, Laboratorin S. Buzo, Laboratorin Megis, Laboratorin Microtest, Laboratorin Neo Medical, etj.

Përveç bashkëpunimit në fushën e praktikave profesionale KU”Logos” bashkëpunon me këto qendra dhe laboratore dhe për shkëmbim eksperience nëpërmjet projekteve të përbashkëta në fushën mjekësore, trajnimeve dhe internshipeve, mbështetjes për kryerjen e temave të diplomave nga ana e studentëve më të mirë. Angazhimi i këtyre studentëve pranë këtyre laboratoreve po ashtu është një mundësi shumë e mirë për ta për tu afirmuar e për t’ju krijuar mundësia e punësimit pas përfundimit të studimeve. Nga ana e punëdhënësve dhe personelit mjekësor të angazhuar me studentët, ka pasur vlerësim shumë pozitiv për të diplomuarit e KU “Logos”.

Gjatë vizitës të grupit të vlerësimit në institucion, në takimin me studentët, ata u shprehën në veçanti të kënaqur me praktikën e zhvilluar pranë Laboratorit “Intermedica”, sepse u ofronte të njiheshin me teknologjinë më të fundit bashkëkohore, krahasuar me laboratorët e tjerë. Ky laborator e ofron bashkëpunimin përkundrejt 0 (zero) tarifeje gjë që i jepte mundësi institucionit që fondin të cilin do ta përdorte për praktikat ta vinte në dispozicion për kërkimin shkencor, si dhe për projekte të tjera brenda institucionit.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni kryen misionin e tij si një ansambël, ku strukturat dhe njësitë e ngritura brenda institucionit bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën me njëra-tjetrën në çdo aspekt, si të veprimtarisë akademike, të kërkimit shkencor, të veprimtarisë edukative dhe administrative, etj.</p> <p>Institucioni realizon analizën vjetore të punës ku evidenton objektivat e realizuara, si dhe ato të parealizuara duke vënë theksin në realizimin e tyre në bashkërendimin dhe bashkëpunimin më të mirë të punës mes personelit brenda institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion nga grupi i vlerësimit u evidentua fryma e lartë e bashkëpunimit midis stukturave dhe njësisve brenda institucionit.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë</p>	<p>Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe si brenda dhe jashtë vendit. U konstatua që një pjesë e këtyre marrëveshjeve të</p>



<p>vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>bashkëpunimit nevojiteshin të konkretizoheshin më tej për të mos ngelur vetëm në letër. Po ashtu, u theksua gjatë vizitës në institucion, nga përfaqësuesja e Zyrës së marrëdhënieve me jashtë që me universitetin e Pireut, Greqi, marrëveshja e bashkëpunimit, e cila ka nisur që prej 2011, ka realizuar shumë prej objektivave të bashkëpunimit. <i>Disa prej marrëveshjeve të bashkëpunimit nevojiten të rinovohen, si psh me Universitetin "Zonja e Këshillit të Mire", apo të saktësohet data e nënshkrimit të marrëveshjes (psh, mungon te marrëveshja me Universitas Sancti Cyrilli, Maltë)</i></p> <p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me laboratorë shtetëror dhe privat për të mundësuar përmirësimin e mëtjshëm të aftësive praktike profesionale të studentëve, për t'ju përgjigjur sa më mirë tregut të punës. Institucioni në kuadrin e këtij bashkëpunimi ka një praktikë dhe rregullore të qartë, si për vlerësimin e praktikës profesionale të studentit nga ana e punëdhënësit ashtu dhe nga ana e pedagogut mbikqyrës. Institucioni po ashtu ruan bazën e të dhënave të vlerësimit të studentëve në praktikën profesionale, duke hartuar dhe një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale. Nga shqyrtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit rezultojnë disa prej tyre që nuk kanë asnjë kosto financiare për institucionin, ndërsa disa të tjera rezultojnë me kosto të ndryshme. Është shumë e rëndësishme që programi i praktikave profesionale të realizohet i plotë dhe i njëjtë për çdo student. Sugjerojmë të rishikohen kontratat e bashkëpunimit, duke i dhënë përparësi laboratoreve që ofrojnë teknologjinë laboratorike më bashkëkohore.</p> <p>Aktualisht institucioni nuk organizon trajnime profesionale por është i angazhuar për aplikimin në të ardhmen.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>1.KU Logos ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda e jashtë vendit, të cilat synojnë rritjen e veprimtarisë kërkimore shkencore të institucionit, rritjen e cilësisë të programeve mësimore, të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të shkëmbimeve të studentëve dhe të stafit akademik.</p> <p>2.Disa prej objektivave të marrëveshjeve të bashkëpunimit ende nuk janë konkretizuar, por institucioni është i angazhuar plotësisht në përmbushjen e të gjitha drejtimeve të bashkëpunimit.</p> <p>3.Rekomandojmë në kuadër të programit Erasmus +, të fuqizohet, të bëhet më aktiv.</p> <p>4.KU "Logos", ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shëndetësore të fushës laboratorike për kryerjen</p>	





e praktikave profesionale, duke ju mundësuar studentëve jo vetëm njohjen me teknologjinë bashkëkohore por dhe me kërkesat e tregut të punës.

*5.Sugjerojmë të rishikohen kontratat e bashkëpunimit, duke i dhënë përparësi laboratoreve që ofrojnë teknologjinë laboratorike më bashkëkohore.*

*6.Aktualisht institucioni nuk organizon trajnime profesionale por është i angazhuar për ti mundësuar në të ardhme.*

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVJ**” sipas metodës **SWOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### a. Pika të forta:

1. Programi i Studimit Bachelor në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë organizohet dhe realizohet në një institucion me eksperiencë dhe profilizim 15 vjecar në fushën e përgatitjes së laborantëve dhe teknikëve të laboratorit me diplomë universitare Bachelor.
2. Baza laboratorike për aftësimin profesional për krijimin e specialistëve Teknikë të Lartë Laboratori me kompetencë reale profesionale është në nivele të mira; e plotësuar dhe me mjete didaktike, garanton realizimin me sukses të praktikave laboratorike.
3. Planet dhe programet mësimore janë hartuar në bazë të modeleve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare duke respektuar standartet dhe kuadrin ligjor në fuqi.
4. Staf i në përgjithësi ka kualifikim dhe eksperiencë për realizimin e programit, ai është i motivuar dhe shumë bashkëpunues.
5. Institucioni ka një politikë mbështetëse dhe inkurajuese për studentin. Ai i siguron studentit jo vetëm përgatitje teorike por dhe praktikë profesionale në institucione laboratorike në funksion të përgatitjes për tregun aktual dhe perspektiv të punës.
6. Ofrimi i tarifave konkurruese në këtë program studimi.
7. KU Logos ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda e jashtë vendit, të cilat synojnë rritjen e veprimtarisë kërkimore shkencore të institucionit, rritjen e cilësisë të programeve mësimore, të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të shkëmbimeve të studentëve dhe të stafit akademik.



**b. Pika të dobëta:**

1. Mospërmbushja e detyrimit ligjor për numrin e personelit akademik efektiv, sipas kërkesës së ligjit 80/2015, neni 25, pika 4, për numrin minimal të anëtarëve.
2. Mospërputhja në ndonjë rast e fushës së ekspertizës së pëdagogut me lëndën që mbulon në këtë program studimi.
3. Moshë relativisht e lartë e personelit akademik efektiv, në këtë program studimi.
4. Lëvizje të konsiderueshme të personelit akademik kryesisht atij me kontratë.
5. Mungesa e personelit akademik efektiv të profilit të Mjekëve të Specializuar në fushat e Mjekësisë Laboratorike.
6. Numri i lartë i ECTS në disipinat plotësuese krahasuar me lëndet ndërdisiplinore/integruese.
7. Mungesa e literaturës në gjuhën shqip apo materialeve të shtypura kryesisht në lëndët karakterizuese.
8. Në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të personelit akademik dhe administrativ, nuk është qartësuar mirë mënyra e analizimit të vlerësimit të tyre.
9. Aktualisht institucioni nuk organizon trajnime profesionale.
10. Angazhimi i ulët i stafit në projekte konkrete kërkimore shkencore dhe mungesa e një infrastrukture bashkëkohore të kërkimit shkencor.

**c. Mundësitë:**

1. Funkionimi në përbërje të Fondacionit Logos i siguron KU mbështetje dhe garanci financiare.
2. Vënia në eficiencë të plotë e laboratorëve, standartizimi, modernizimi dhe akreditimi i tyre mundëson pozicionimin e dukur të KU Logos në fushën e diagnozës laboratorike dhe të kërkimit shkencor.
3. Ky program studimi është një programet më të kërkuara në funksion të rritjes së shërbimit shëndëtsor në vend.
4. Sistemi i bursave mundëson tërheqjen e studentëve me cilësi të lartë.
5. Mundësitë për mobilitet të studentëve dhe stafeve akademike përmes projekteve dhe programeve të BE

**d. Pengesat:**

1. Mungesa e një tregu të konsoliduar e të rregulluar të arsimit të lartë jopublik
2. Pengesa relative për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë me titull profesor ose profesor i asociuar; dhe e stafit akademik të specializuar në Mjekësinë Laboratorike .
3. Tendencë në ulje të numrit të studentëve të regjistruar.





**e. Rekomandime:**

1. Rekrutimi i stafit akademit me kohë të plotë Mjekëvë të Specializuar në fushat e Mjekësisë Laboratorike.
2. Ndryshime në programin mësimor si më poshtë:
  - a. Uljen e krediteve në lëndët Kimi inorganike dhe organike.
  - b. Uljen e krediteve të lëndëve Sigurim Teknik dhe Biosiguri, ose realizimin në një modul të kombinuar.
  - c. Të shikohet mundësia e shtimit të temave të Biofizikes dhe Optikës ndoshta në një lënde të vecantë.
  - d. Të futet si lëndë e vecantë ose cikël leksionesh Automatimi në Laboratorët Mjekësorë dhe Sistemet e Informatizimit Laboratorik (LIS).
3. Përmirësimi i literaturës në gjuhën shqipe, kryesisht për lëndët bazë të programit.
4. Rekomandohen trajnime didaktike paraprake për çdo form të re të mësimdhënies.
5. Furnizimi me reagent dhe me pajisjet laboratorike, duhet të jetë i garantuar përgjatë gjithë vitit mësimor në mënyrë që të mos ketë asnjë mungesë në zhvillimin e praktikave laboratorike.
6. Rekomandohet që pyetësi i studentëve të bëhet nëpërmjet sistemit elektronik (në kushtet kur ofrojnë programe në fushën e IT), duke bërë të mundur përpunimin e të dhënave online në kushte anonimiti, të cilat më pas do të analizohen nga NjSBC në nivel fakulteti dhe Institucioni.
7. Rekomandojmë në kuadër të programit Erasmus +, të fuqizohet, të bëhet më aktiv.
8. Rekomandojmë të rishikohen kontratat e bashkëpunimit, duke i dhënë përparësi laboratoreve që ofrojnë teknologjinë laboratorike më bashkëkohore.

**SUMMARY ANALYSIS OF THE IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAM**

EER concludes with the "Summary of EER", in accordance with the **SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)** analysis method.

**a. Strengths:**

1. The study programme of Bachelor in Advanced Medical Laboratory Techniques takes place in a highly experienced institution with 15 years of profiling and preparing of laboratory technicians .



2. The laboratory logistics, necessary for the vocationing of professionally competent technicians, are sufficiently available; augmented with didactic equipment, it guarantees the successful fruition of the laboratory practices.
3. Study plans and programmes have been designed based on the best available national and international programmes, complying to the standards and legal frameworks in effect.
4. The staff is generally well experienced and possesses the proper qualifications exacted for the programme; they are highly motivated and very cooperative.
5. The institution employs encouraging and supportive policies for the students. It provides not only theoretic vocationing but also professional, hands-on practice in laboratoric institutions in the context of the vocationing for the current market and the employment perspective in general.
6. The offering of competitive fees for the study programme.
7. The University Council of Logos currently partakes in partnerships with homologous institutions both nationally and internationally, aiming to increase scientific research activity and to improve the quality of the study programmes as well as of the exchange/mobility programmes for both students and academic personnel.

**b. Weaknesses:**

1. The inability to fulfill the legal requirement for the number of the effective academic personnel, proclaimed under article 25, point 4, law no. 80/2015 on the minimal number of personnel.
2. Discrepancy in any case of the expertise field of the lecturer with the subject covered in this study program.
3. The relatively high median age of the effective personnel in this study programme.
4. The considerable turnover rate for academic personnel, mainly of the portion that is under contract.
5. The lack in numbers for effective academic personnel with qualifications in Laboratory Medicine.
6. The high number of ECTS assigned to complementary single-discipline subjects as compared to integral or interdisciplinary subjects.
7. The lack of literature in the Albanian language or written materials for core subjects.
8. The lack of clarity with regard to the means of evaluation of academic and administrative personnel.
9. The current lack of professional training in the institution.
10. The low level of engagement of the staff in practical scientific research projects as well as the lack of contemporary infrastructure with regard to scientific research.

The page contains two handwritten signatures in blue ink. The first signature is a cursive 'M. P.' and the second is a more elaborate, flowing signature.



**c. Opportunities:**

1. The functioning as a constituency of the Logos Foundation ensures financial support and guarantees to the UC.
2. The complete utilization of laboratories as well as the completing of their standardization, modernisation and accreditation, enables the public recognition of UC in the field of laboratory diagnosis and scientific research.
3. The programme is one of the most preferred programs in the context of the improvement of healthcare services in the country.
4. The scholarship programme allows for the attracting of high quality students.
5. The mobility programmes for students and academic personnel within the frameworks of EU projects and programmes.

**d. Threats:**

1. The lack of standardization and regulation in the non-public higher education market.
2. The relative burden in recruiting full-time academic personnel, especially with the qualifications of Professor or Associate Professor, as well as Laboratory Medicine personnel.
3. A tendency to decline of the numbers of registered students.

**e. Recommendations**

1. The recruitment of full-time academic staff personnel with qualifications in Laboratory Medicine.
2. The making of alteration in the study programme such as:
  - a. Reducing the number of ECTS for the subjects of Inorganic Chemistry.
  - b. Reducing the number of ECTS for the subjects of Technical Safety and Biosafety, or the merging of the two subjects into one single module.
  - c. Assessing the possibility of adding the topics of Biophysics and Optics in a separate subject.
  - d. Adding as a new subject or as a series of lectures the modules of Automatization of Medical Laboratories and Laboratory Information Systems (LIS).
3. Refining the study materials in the Albanian language, primarily for the core subjects of the programme.
4. The conducting of preliminary didactic training for every newly presented methodology in the teaching process.
5. The supply of laboratory logistics should be guaranteed throughout the entire year in order for laboratory practice sessions to take place without being affected.





6. The conducting of student questionnaires by electronic means(provided that study programmes related to IT are offered), ensuring anonomy during the examination of responses which will in turn be examined at institutional and/or faculty level by the “IQAU”.
7. The further emphasizing of Erasmus + programme.
8. The reviewing of partnership agreements, putting at an advantage the laboratories that offer the most up-to-date technology.

**Grupi i vlerësimit të jashtëm:**

**Dr. Nevila Heta**



**Dr. Irena Korita**

